REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**REKTORATI**

Nr. 2672/9 prot. Elbasan, me 09.02.2024

**KONTRATE PUBLIKE PËR PUNË**
**"Rikonstruksion salla e konferencave 111-FSHE"**

E lidhur sot në datë 09.02.2024 në Universitetin "A.Xhuvani" Elbasan, mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr.162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" , dhe VKM-ja nr.285 dt.19.05.2021 "Rregullat e Prokurimit Publik",, sipas kushteve të mëposhtme:

**A. KREU I: KUSHTET E VEÇANTA (Mallra)**

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

**Neni 1: Përkufizime**

- Autoriteti Kontraktor është - **Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani", përfaqësuar nga Administratori Eljan Hoxha,** njohur më poshtë si **"AUTORITETI KONTRAKTOR" (Blerësi Publik).**
- Kontraktuesi është – **Operatori Ekonomik Shoqëria** Ekonomik **"INA" shpk,** me administrator z..Ferdinand Çaushi , me adresë Tiranë: Ruga "Besim Imami", rregjistruar më date 25.10.1995 , Nipt- **J61814009W,** i cili përfaqëson këtë subjekt për detyrimet e kësaj kontrate i njohur më poshtë si **"Kontraktuesi" (shitësi).**

**Neni 2: Objekti i kontratës**

Mbi bazën e dokumentacionit që disponon pas fitimit të prokurimit publik të zhvilluar në datë 30.11.2023, do të kryej realizimin e punëve për objektin: "Rikonstruksion salla e konferencave 111-FSHE"

**Neni 3: Drejtuesi i projektit (Mbikqyrësi i Punimeve)**

Drejtuesi i Projektit do të jetë subjekti i licencuar juridik " DAAM" shpk me Nr.liçence MK.3659/5 i cili eshte fitues i procedurës së prokurimit i cili me objekt:, "Mbykeqyrje rikonstruksion salla e konferencave 111-FSHE"

Adresa/pika e kontaktit të tij do t'i komunikohet Kontraktorit zyrtarisht, menjëherë pasi të përfundojë procesi i prokurimit me ofertuesin fitues si dhe nënshkrimin e kontratës së shërbimi

**Neni 4: Kantieri**

Kantieri i Punëve do të jenë ambientet godina e Fakulteteti i Shkencave te Edukimit, ambient i cili është në pronësi të autoritetit kontraktor.

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN

**Neni 5: Data e Fillimit**
Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate nëpërmjet dokumentimit të lirimit të ambienteve dhe dorëzimit të tyre.

**Neni 6: Sigurimi i Kontratës**
Garancia e kontratës e paraqitur nga Kontraktuesi para lidhjes së kontratës, sipas modelit përkatës dhënë në dokumentat e tenderit ka vlerën 10% të vlerës së kontratës në shumën absolute 1,274,686 lekë. Kjo shumë do të garantojë autoritetin kontraktor për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi (shitësi).
Çlirimi i garancisë së kontratës do të bëhet me shkrim nga Blerësi Publik, 30 ditë pas përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi.

**Neni 7: Siguracioni**
Nga data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:

a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve
b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve
c. Për dëmtime ose humbje të pasurise përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve
d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier.

**Neni 8: Inspektimet dhe Testimet**
Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë të gjitha zërat e punimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor në përputhje me ofertën e paraqitur nga kontraktori, në cilësinë dhe sasinë e kërkuar, të përcaktuara në dokumentat e tenderit (shtojca 6) dhe të pranuara nga Kontraktuesi në dokumentat e ofertës të paraqitura nga ky operator ekonomik në tenderin e zhvilluar nga autoriteti kontraktor në datë 08.06.2021.

**Neni 9: Çmimi i Kontratës**
Kjo kontratë do të çmohet si një:

- *Kontratë me Çmim Njësie* të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
- *Kontratë me Shumë Totale*

**Vlera totale kontratës** (pa tvsh) është **11,374,873.6** (Njëmbedhjetëmilion e treqind e shatëdhjetë e katërmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë) lekë
**Vlera e plotë e kontratës** (me tvsh) që do ti paguhet kontraktuesit është **12,746,858** (Dymbëdhjetëmilion e shatëqind e dyzetë e gjashtëmijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë

**Neni 10: Fillimi i zbatimit dhe mënyra e levrimit**
10.1 Grafiku i realizimit të punimeve është me afat 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, sipas Shtojcave 6 "Grafiku i Zbatimi të Punimve"dhe Shtojca 5 "Preventivi i Punimve" të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
10.2 Pagesa për punët e kryera duhet bërë brenda 30 ditëve nga dita që sipërmarrësi (Blerësi Publik) paraqet faturën tatimore të shoqëruar me situacionin përfundimtar dhe dokumentacionet për punimet e kryera si dhe pas paraqitjes së raportit të drejtuesit të projektit (mbikëqyrësit të punimeve) me proces verbalin e marrjes në dorezim të punimeve nga investitori.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

**Neni 11: Kushtet e Pagesës**

11.1 Pagesa do të kryhet kundrejt paraqitjes së dokumentacionit justifikues (faturës) të rregullt, të pranuar nga autoriteti kontraktor, **brenda 1 (një) muaji** nga dita e paraqitjes së dokumentit. Monedha me të cilën do të bëhet pagesa është **Lek.** Numri i llogarisë bankare të Kontraktuesit është në: **Raiffeisen Bank,** në llogarinë e subjektit **"INA"** shpk me **IBAN:** [redacted]

Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

11.2 Referuar kushteve dhe kritereve të DST ka rezultuar se Autoriteti Kontraktor: Nuk ka të parashikuar pagesë paraprake

**Neni 12. Shërbimet në Lidhje me to**

Kushtet e veçanta të mëposhtme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura.

**Neni 13. Zbritja e garancisë së kontratës**

Nuk është parashikuar zbritje e garancisë së kontratës.

**Neni 14. Dokumentacioni dhe oferta**

Pjesë integrale dhe e pandarë e kësaj kontrate është oferta ekonomike si dhe gjithë dokumentacioni i projektit teknik mbi bazën e të cilit do të realizohet objekti i kësaj kontrate.

**Neni 15: Zgjidhja e kontratës**

Kontrata mund të zgjidhet duke pushuar çdo efekt të saj me njoftimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktor në rastet e mëposhtme :

1. Në rastin e mosrealizimit të punëve sipas kërkesës së autoritetit kontraktor pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.
2. Në rast mosplotësimi të kërkesave të realizimit të punëve objekt kontrate dhe mospranimit nga Kontraktuesi për zëvëndësimin e tyre me një punë tjetër njëlloj me të parën, që i përmbush këto kërkesa pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e mësipërm kontrata do të zgjidhet duke respektuar dispozitat e Kodit Civil.

**Neni 16: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Për çdo marrëveshje që mund të lind në zbatimin e kontratës, nëse ato nuk zgjidhen në marrëveshje midis palëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

## Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**Neni 1: Dispozitat e përgjithshme**

1.1 **Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1.1. **Kontrata**



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

ELBASAN

1.1.1.1."Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

1.1.1.2."Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

1.1.1.3."Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

1.1.1.4."Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

1.1.1.5."Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.

1.1.1.6."Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

1.1.1.7."Termat e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

1.1.1.8. "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

1.1.1.9. "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

1.1.1.10. "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.1.1.11. "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.1.2. **Palët e Kontratës**

1.1.2.1."Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Autoritetit kontraktor dhe Kontraktorit (realizuesit të punimeve)sipas kontekstit.

1.1.2.2."Kontraktori" do të thotë operatori (ët) ekonomik që do të realizojë punimet objekt kontrate.

1.1.2.3."Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

1.1.3. **Datat, Testet, Periudhat dhe Përfundimi**

1.1.3.1. "Test i materiale/pajisjeve" do të thotë testet (nëse janë të aplikueshme) të cilat janë specifikuar në Kontratë dhe që kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe legjislacionin e fushës, për qëllimin e përcaktimin të parametrave të materialeve/ pajisjve, para se të lejohet përdorimi/montimi/instalimi i tyre në objekt.

1.1.3.2."Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

1.1.4. **Punimet**

1.1.4.1. "Punime" do të thotë të gjitha proceset që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori për realizimin e objektit të kontratës. Përfshijnë gërmimin, ndërtimin, riparimin, rinovimin, instalimin, formatimit, testimin, zhvendosjen, transportin dhe cdo procss që është parashikuara në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit

1.1.4.2."Shërbime të Lidhura" do të thotë shërbimet e rastit të lidhura me realizimin e proceseve, siç janë sigurimi, transporti, instalimi, vënia në punë, trajnimi dhe mirëmbajtja fillestare ose ndonjë shërbim tjetër i kësaj natyre sipas Kontratës.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

1.1.5. **Përkufizime të tjera**
1.1.5.1. "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.
1.1.5.2."Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 25 "Forca Madhore".
1.1.5.3."Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 10 "Sigurimi i Kontratës".
1.1.5.4. "Vendi i realizimit të kontratës" apo "kantieri", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.
1.1.5.5."E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.
1.1.5.6.Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 26.
1.1.5.7."Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.
1.1.5.8.Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

1.2 **Interpretimi**

**1.2.1. Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:**

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;
(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

**1.2.2. Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

**1.2.3. Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

**1.2.4. Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

1.3 **Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK; dhe
(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al
ELBASAN

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe
(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa. Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

1.4 **Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë. Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

1.5 **Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Bleresi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

1.6 **Hartimi i Kontratës**

1.6.1. Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

1.6.2. Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

1.7 **E drejta e autorit**

1.7.1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Bleresit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Bleresit, edhe nëse ato i janë furnizuar Bleresit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

1.8 **Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Bleresit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Bleresi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

**1.9 Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Bleresi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) te ketij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

**1.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

**1.11 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) ) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2: Praktikat e Ndaluara**

2.1.Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

2.2.Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfiktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3: Njoftimet**

1.1.Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

1.2.Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4: Objekti i Kontratës**

4.1.Punimet, materialet/pajisjet/produket dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të realizohen apo përdoren gjatë realizimit të kontratës duhet të jenë sipas specifikimeve teknike, projekteve përkatëse, termave të referencës apo detyrës së projektimit nëse është rasti,sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me stardardet teknike në fuqi.

4.2.Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Kontraktori, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5: Realizimi i punimeve**

5.1. Realizimi i të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyrë projektimi, nëse është rasti, si dhe i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me stardardet teknike në fuqi.

**Neni 6: Përgjegjësitë e Kontraktorit**

6.1.Kontraktori do të jetë përgjegjës për realizimi i të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyrë projektimi, nëse është rasti si dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në objektin e kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me standardet tenike në fuqi.

**Neni 7: Çmimi i Kontratës**

7.1.Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 19.

**Neni 8: Kushtet e Pagesës**

8.1.Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK. Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

8.2.Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

8.3.Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

8.4.Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 9 Tatimet, Taksat dhe Detyrimet e tjera**

9.1. Për materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës, të prodhuara jashtë vendit të Autoritetit Kontraktor, Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

për të gjitha tatimet dhe taksat, taksat e pullës, tarifat e licencës dhe detyrime të tjera të tilla të vendosura jashtë vendit të Autoritetit Kontraktor

9.2. Për materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës, të prodhuara brenda vendit të Autoritetit Kontraktor Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, detyrimet, tarifat e licencës, etj., të lindura deri në realizimin e plotë dhe dorëzimin e objektit të kontratës, të Autoriteti Kontraktor

9.3. Nëse në vendin e Autoritetit Kontraktor mund të jetë i disponueshëm për Kontraktorin ndonjë përjashtim, ulje, lejim ose favor tatimor, Autoriteti Kontraktor duhet t'i krijojë mundës Kontraktorin të përfitojë nga këto lehtësira.

**Neni 10: Sigurimi i Kontratës**

10.1. Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.

10.2. Në përputhje me Nenin 11.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.

10.3. Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.

10.4. Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 11: Nënkontraktimi**

11.1. Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.

11.2. Autoriteti Kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për punet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Kontraktuesit.

11.3. Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 12: Specifikimet dhe Standardet**

12.1. Kontraktori duhet të sigurojë që punimet, Shërbimet e Lidhura, apo materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës, të jenë sipas specifikimeve teknike, projekteve përkatëse, termave të referencës apo detyrës së projektimit nëse është rasti, sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me stardardet teknike në fuqi.

12.2. Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekte, preventiv, detyrë projektimi, terma reference, ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktori duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoriteti Kontraktor për të

12.3. Kudo që bëhen referenca në Kontratë për kodet dhe standardet, në përputhje me të cilat do të ekzekutohet, shtesa ose versioni i rishikuar i kodeve dhe standardeve të tilla, do të jenë ato të specifikuara në kërkesat e dokumenteve të tenderit. Çdo ndryshim në cilindo kod dhe standard, gjatë ekzekutimit të Kontratës, do të zbatohet vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor i dhe do të trajtohet në përputhje me Nenin 26 të këtyre kushteve dhe dispozitat e LPP-së për modifikimin e Kontratës, Neni 127.



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

12.4. Kontraktori, në rast se evitohen mospërputhje apo mangësi në projekt-preventiv dhe kantier, brenda një afati të përcaktuar në kontratë, paraqet kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës.

12.5. Autoriteti Kontraktor administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të shqyrtohen në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

**Neni 13 Testimet dhe Inspektimet**

13.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës. Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose pregatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

13.2 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

13.3 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

13.4 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës

**Neni 14: Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

14.1. Përveç nëse specifikohet ndryshe në KVK, Kontraktuesi duhet të sigurojë punimet, Shërbimet e Lidhura, apo materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit të lidhur me realizimin, prodhimin ose blerjen, transportin, apo cdo procesi tjetër, në përputhje me Inkotermat e zbatueshme ose në mënyrën e specifikuar në KVK.

**Neni 15. Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

15.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

15.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 16: Zbulimet**

16.1. Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen per te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhezimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

**Neni 17: Disponimi i Kantierit**

17.1. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

**Neni: 18: Masat në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë.**

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet dhe Kontraktori duhet te sigurohen, që gjatëë zbatimit të kontratës të përmbushin detyrimet lidhur me kërkesat e sigurisë së shëndetit, punëve, ambientit për punët, apo nevojave për aftësi ose përvojë të specializuar mjedisore, sociale ose shëndetësore dhe të sigurisë, sikurse përcaktohet gjatë përgatitjes së dokumenteve të prokurimit.

18.2 Specialistët e sigurisë në punë, pjesë e stafit/personelit të Kontraktorit, duhet të disponojnë kualifikimet e parashikuara në legjislacionin e fushës, për marrjen e masave të e nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e sigurisë në punë, gjatë zbatimit të objektit të kontratës.

**Neni: 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

19.2 Në intervale të skeduara rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

**Neni 20: Dëmet e likujduara**

20.1.Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 21 Garancia**

21.1. Kontraktori garanton se materialet/pajisjet/produktet e përdoruara gjatë realizimit të punimeve janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se sigurojnë përmirësimet e duhura të objektit të prokurimit, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë. Me



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax +355 542 52593, Web www.uniel.edu.al

përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se punimet apo materialet/pajisjet/produktet e përoruara gjatë realizimit të punimeve, nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi/zbatimi, cilësia e tyre në prodhim, apo nga puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

21.2. Autoriteti Kontraktor përcakton në KVK kohëzgjatjen e vlefshmërisë së garancisë (nëse është rasti), pasi punimet objekt kontrate, ose ndonjë pjesë e tyre sipas rastit, të jenë realizuar dhe marrë në dorëzim pas përfundimit të tyre.

21.3. Kontraktori do të njoftojë Autoritetit Kontraktor duke treguar natyrën e problemeve/defekteve të tilla së bashku me të gjitha provat e disponueshme të tyre, menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se dhjetë ditë nga zbulimi. Autoriteti Kontraktor do të sigurojë të gjitha mundësitë që Kontraktori të inspektojë defekte të tilla.

21.4. Pas marrjes së njoftimit, Kontraktori i duhet, brenda periudhës së specifikuar në KVK, të riparojë ose zëvendësojë me shpejtësi materialet/pajisjet/produktet ose pjesët e dëmtuara, pa ndonjë kosto për Autoritetit Kontraktor

Nëse pas marrjes së njoftimit, Kontraktori nuk arrin të rregullojë defektin brenda periudhës së specifikuar më sipër, Autoriteti Kontraktor mund të kryejë rregullimet e nevojshme me shpenzimet e Kontraktorit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor mund të vendosë që të njoftojë Kontraktuesin për ndërprerjen e Kontratës.

**Neni 22: Zhdëmtimi i Patentës**

22.1. Kontraktori dëmshpërblen dhe zhdëmton Bleresin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Autoriteti Kontraktor mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) realizimit të punimeve apo instalimit të materialeve/pajisjeve/produkteve gjatë realizimit të objektit te kontratës Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse materialet/pajisjet/produktet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është paraqitur nga Kontraktori, në përputhje me Kontratën.

22.2. Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Autoriteti Kontraktor që del nga çështjet e përmendura në Nenin 22.1, Bleresi do të njoftojë menjëherë Kontraktorin dhe Kontraktori mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Autoriteti Kontraktor të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

22.3. Nëse Kontraktori nuk e njofton Autoritetin Kontraktor brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Autoritetin Kontraktor do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij. Autoriteti Kontraktor me kërkesën e Kontraktorit, do ti japë këtij të fundit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Kontraktori për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë. Autoriteti Kontraktor dëmshpërblen dhe zhdëmton Kontraktorin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Kontraktori mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo projekt, specifikim teknik, të dhënë, vizatim, apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Autoritetit Kontraktor

**Neni 23: Kufizimi i Përgjegjësisë**

23.1. Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

a) Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktor, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Kontraktroti për t'i paguar Autoritetit Kontraktor dëmet e likujduara;
Dhe

b) përgjegjësia e përgjithshme e Kontraktorit ndaj Autoritetit Kontraktor, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e riparimit ose zëvendësimit të materialet/pajisjet/produktet me defekt, ose çdo detyrim të Kontraktorit për të zhdëmtuar Autoritetit Kontraktor në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 24: Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

24.1. Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 25: Forca madhore**

25.1.Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

25.2.Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

25.3.Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore.

**Neni 26: Modifikimi i Kontratës**

26.1. Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

26.2. Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve

b) Korrigjime në materiale

c) Korrigjime në sasi

26.3. Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

26.4. Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 27: Zgjatja e afatit**

27.1. Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

27.2. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit të Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

27.3. Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Kontraktori ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë realizimin në kohë të punimeve objekt kontrate në përputhje me Nenin 5, Kontraktori njofton menjëherë Autoritetit Kontraktor me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Kontraktorit, Autoritetit Kontraktor vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana eKontraktorit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

27.4. Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 25, një vonesë nga Kontraktori në kryerjen e detyrimeve të përfundimit sipas grafikut të punimeve objekt kontrate do ta bëjë kontraktorin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

27.5. Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

**Neni 28: Ndërprerja e Kontratës**

28.1. **Njoftim për të korrigjuar**

Nëse Kontraktori nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Autoriteti Kontraktor mund ti kërkojë me Njoftim që të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

28.2. **Ndërprerja për mospërmbushje** Autoriteti Kontraktor pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Kontraktorit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë;

ose,

b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
c) Nëse provohet se Kontraktori është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

**Neni 29: Ndërprerja për paaftësi paguese**

29.1. Autoriteti Kontraktor ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Kontraktorin nëse Kontraktori falimenton. Kontraktori ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Autoriteti Kontraktor nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Kontraktorin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Autoritetin Kontraktor

**Neni 30: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

a) Autoriteti Kontraktor i mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
b) Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë me shkrim Kontraktorin për ndërprerjen.
c) Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktorin për të gjitha punimet që janë marrë në dorëzim përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktorit dëmet e shkaktuara Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktorit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 31 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

31.1. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.
31.2. Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

**Kjo kontratë u përpilua në katër kopje duke u ndarë në tre kopje për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin.Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të të dyja palët, të cilët e firmosën dhe e vulosën atë respektivisht në çdo faqe.**

| | |
|---|---|
| **PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR** | **PËR KONTRAKTUESIN** |
| **Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"** | **"INA" SHPK** |
| **ADMINISTRATORI** | **ADMINISTRATOR** |
| **Eljan Hoxha** | **Ferdinand Çaushi** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
## REKTORATI

## ANEKS KONTRATE
### "Rikonstruksion salla e konferencave 111-FSHE

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PUNIME NDERTIMORE** | | | | |
| **A-1** | | **PUNIME PASTRIMI DHE PRISHJE** | | | | |
| 1 | An-1 | Prishje suva brenda mur tulle. | m² | 150.0 | 250.0 | 37,500.0 |
| 2 | An-2 | Prishje suva solete h-4 m | m² | 113.0 | 220.0 | 24,860.0 |
| 3 | An | Prishje e pllakave ekzistuese + nenshtres | m² | 125.0 | 200.0 | 25,000.0 |
| 4 | An | Heqje dritare ekzistuese | cope | 3.0 | 2,500.0 | 7,500.0 |
| 5 | 2.37/5b | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km | m3 | 10.5 | 420.0 | 4,410.0 |
| **Shuma A-1** | | | **Leke** | | | **99,270.0** |
| **A-2** | | **PUNIME NDERTIMI** | | | | |
| 1 | 2,303 | Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah | m² | 113.0 | 890.0 | 100,570.0 |
| 2 | 2.310+An | Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 + fino | m² | 110.0 | 850.0 | 93,500.0 |
| 3 | 2.308/a | Suvatim me grafiato h > 4 m | m² | 8.0 | 2,150.0 | 17,200.0 |
| 4 | 2.96/b | Veshje muri me MDF | m² | 180.0 | 3,520.0 | 633,600.0 |
| 5 | 2.297/b | Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm | m² | 210.0 | 2,550.0 | 535,500.0 |
| 6 | 2.404/1 | Boje hidroplastike importi cilesi e I-re | m² | 300.0 | 180.0 | 54,000.0 |
| 7 | 2.388/1 | V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara, me sistem doreze hapje antipanik/antizjarre | m² | 4.2 | 15,500.0 | 65,100.0 |
| 8 | 2.276 | Shtrese parketi laminat | m² | 300.0 | 2,500.0 | 750,000.0 |
| 9 | 2.196/c | Hidroizolim me dy shtresa mapej | m² | 250.0 | 1,250.0 | 312,500.0 |
| 10 | 2,264 | Shtrese lluster cimento 1:2 | m² | 250.0 | 650.0 | 162,500.0 |
| 11 | 2.273 | Pragje dritaresh me pllaka mermeri t = 2cm | m² | 3.0 | 5,500.0 | 16,500.0 |
| 12 | 2.372+An | F.V.Vetrata duralumini me dopio xham gjyse struktural | m2 | 25.0 | 11,200.0 | 280,000.0 |
| 13 | An | Karrike per salla konferencash | cope | 110.0 | 4,000.0 | 440,000.0 |


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "ALEKSANDER XHUVANI" ELBASAN

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | An | Karrike per salla konferencash me hapje/tovoline te vogel plastike | cope | 12.0 | 9,500.0 | 114,000.0 |
| 15 | An | F.v.Poltrone rrotulluese per pedagoget | cope | 6.0 | 13,500.0 | 81,000.0 |
| 16 | An | F.v.Podium melamine per sallat e leksioneve 178 cm x 40 cm x 450 cm | cope | 1.0 | 32,500.0 | 32,500.0 |
| 17 | An | Tavolinë MDF referimi salle (foltore) Përmasat (gjeresi x thellesi x lartesi): 80 x 60 x 125 cm | cope | 1.0 | 22,500.0 | 22,500.0 |
| 18 | An | F.v.Foltore melamine per sallat e leksionit | cope | 1.0 | 55,000.0 | 55,000.0 |
| 19 | An | F.v.Foltore material pecikllasi per sallat e leksionit | cope | 1.0 | 65,000.0 | 65,000.0 |
| 20 | An | Tavolinë e mesme MDF mbledhjesh Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): 255 x 70 x 72 cm | cope | 1.0 | 45,000.0 | 45,000.0 |
| 21 | An | F.v. shirita mbrojtese muri MDF 15 cm hyrja ne sallen e konferances | ml | 8.0 | 3,500.0 | 28,000.0 |
| 22 | An | F.v.Tavoline per dhomen e perkthimit 180 cm x 75 xm x 70 cm | cope | 1.0 | 25,000.0 | 25,000.0 |
| 23 | An | Dhome ( kabine ) perkthimi 1/2 xham 10 mm I temperuar me permasa 2.5 x 2 | cope | 1.0 | 32,500.0 | 32,500.0 |
| **Shuma A-2** | | | **Leke** | | | **3,961,470.0** |
| **A-3** | | **RRJETI ELEKTRIK** | | | | |
| 1 | 480/2 | F.V. Tub fleksibel PVC,djegje pa flake dhe emetim gazi, Ø32mm me aksesore | ml | 50.0 | 95.0 | 4,750.0 |
| 2 | 480/3 | F.V. Tub fleksibel PVC,djegje pa flake dhe emetim gazi, Ø25mm me aksesore | ml | 120.0 | 85.0 | 10,200.0 |
| 3 | 480/5 | F.V Tub fleksibel PVC, djegje pa flake dhe emetim te ulet gazi, tip i rende, Ø=20 mm | ml | 120.0 | 75.0 | 9,000.0 |
| 4 | An | F.V. Kuti shperndarese per instalim brenda murit PT 7, IP 40 | cope | 5.0 | 2,650.0 | 13,250.0 |
| 5 | An | F.V. Kuti shperndarese C5 150x110x70 IP54 per instalim jashte murit . | cope | 2.0 | 3,250.0 | 6,500.0 |
| 6 | 2.481/2 | F.V Percjelles nje polar, me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=450/750 V, tip N07V-K, S = 1 x 2.5 mm² | ml | 950.0 | 150.0 | 142,500.0 |
| 7 | An | F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 2.5 mm² | ml | 30.0 | 350.0 | 10,500.0 |
| 8 | An | F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 4 mm² | ml | 40.0 | 750.0 | 30,000.0 |

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | An | F.V. Perejelles FS17 S=1x1.5mm2 | ml | 320.0 | 150.0 | 48,000.0 |
| 10 | An | F.V. Kabell boksesh 2X2.5 mm | ml | 150.0 | 250.0 | 37,500.0 |
| 11 | An | F.V. UPS 3 Kva | cope | 1.0 | 135,000.0 | 135,000.0 |
| 12 | An | F.V. Kuti, suporte, kapak per celesa e priza 3-module, per instalim brenda murit . | cope | 20.0 | 500.0 | 10,000.0 |
| 13 | An | F.V Kuti shperndarse plastike brenda muri PT5 | cope | 7.0 | 1,250.0 | 8,750.0 |
| 14 | 2.485 | F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim | cope | 20.0 | 650.0 | 13,000.0 |
| 15 | An | F.V. Prize Shuko 2P+T 16A 2 module , per instalim brenda murit | cope | 8.0 | 650.0 | 5,200.0 |
| 16 | An | F.V. Prize Shuko 2P+T 16A 2 module e kuqe | cope | 4.0 | 650.0 | 2,600.0 |
| 17 | An | FV - Celes buton Pulsant 1P 16A 230V 10A | cope | 5.0 | 580.0 | 2,900.0 |
| 18 | An | F.V Çeles deviater 16 A, 230 V | cope | 2.0 | 3,250.0 | 6,500.0 |
| 19 | An | F.V Panel Elektrik KE-02<br>- Me shkarkues mbitensioni 3~ 400V/ 50Hz;<br>- Me dere me celes, IK07 me xham transparent;<br>- Komp.me kit zbara & aksesor J/m;<br>- Shkalla e mbrojtjes: tip metalik, montim jashte murit IP 40;<br>- (i kompletuar me te gjithe aksesoret, sipas skemes qe jepet ne projekt) | komplet | 1.0 | 325,000.0 | 325,000.0 |
| 20 | An | F.V Ndriçues LED Panel inkaso, 60x60cm, 36W, 3600lm, 5000K | cope | 15.0 | 3,250.0 | 48,750.0 |
| 21 | An | F.V Ndriçues emergjence, rezistent ndaj zjarrit, LED 8W, IK 07, IP-65,me bat.NiCd me autonomi 3orë | cope | 2.0 | 3,120.0 | 6,240.0 |
| 22 | An | F.V Ndriçues evakuimi me shenjë tregues dalje (EXIT), rezistent ndaj zjarrit IP-40, IK 07, LED 8W bat.NiCd me autonomi 3orë | cope | 2.0 | 2,950.0 | 5,900.0 |
| | | **Shuma A-3** | | | | **882,040.0** |
| **A-4** | | **SISTEMI AUDIO PAS & MM** | | | | |
| 1 | An | F.V Amplifikator me 2X250W & 5 audio in | cope | 1.0 | 65,800.0 | 65,800.0 |
| 2 | An | F.V Amplifikator me 2X125W & 2 audio in | cope | 3.0 | 45,000.0 | 135,000.0 |
| 3 | An | F.V Altoparlant tavanor 12W 100V | cope | 4.0 | 9,500.0 | 38,000.0 |
| 4 | An | F.V Altoparlant hinke 15W 100V | cope | 2.0 | 8,500.0 | 17,000.0 |
| 5 | An | F.V Altoparlant tip BOX mural 15W 100V | cope | 4.0 | 7,500.0 | 30,000.0 |

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | An | F.V Cift konverter HDMI - LAN | cope | 4.0 | 6,200.0 | 24,800.0 |
| 7 | An | F.V Prize modulare HDMI komplet | cope | 4.0 | 3,250.0 | 13,000.0 |
| 8 | An | F.V Prize modulare mikrofon jack XLR | cope | 4.0 | 2,500.0 | 10,000.0 |
| 9 | An | F.V Kabell per mikrofon 2x(20/0.12mm BC OFC) | ml | 200.0 | 250.0 | 50,000.0 |
| 10 | An | F.V Kabell E30 2x1mm2 | ml | 100.0 | 210.0 | 21,000.0 |
| 11 | An | F.V Tub fleksibel PVC, djegje pa flake dhe emetim te ulet gazi, tip i rende, Ø=25 mm | ml | 50.0 | 75.0 | 3,750.0 |
| | | **Shuma A-4** | | | | **408,350.0** |
| A-5 | | **PAISJE SISTEMI I PERKTHIMIT** | | | | |
| 1 | An | V.Mbajtese tavanore projektori profesional | cope | 1.0 | 1,500.0 | 1,500.0 |
| 2 | An | F.V.Fish HDMI 20m | cope | 1.0 | 3,200.0 | 3,200.0 |
| 3 | An | F.V.Fish VGA 20m | cope | 1.0 | 2,200.0 | 2,200.0 |
| 4 | An | F.V. Kabell rrjeti kompjuterik, Tip FTP-cat6 | ml | 100.0 | 150.0 | 15,000.0 |
| 5 | An | F.V. Priza rrjeti kompjuterik tip RJ-45, cat 6, FTP | cope | 7.0 | 650.0 | 4,550.0 |
| 6 | An | V.Kabinet RACK19;32HE 600x800x1500 NE i kompletuar me aksesore si shina , rrota , vida etj. | cope | 1.0 | 3,500.0 | 3,500.0 |
| 7 | An | V.Switch 16P 10/100/1000 Mbps POE | cope | 1.0 | 2,000.0 | 2,000.0 |
| 8 | An | V.Pajisje Access-Point Wireless i Menaxhueshem | cope | 2.0 | 1,800.0 | 3,600.0 |
| 9 | An | V.Patch panel me 12 porta RJ-45, FTP cat 6 | cope | 1.0 | 3,200.0 | 3,200.0 |
| 10 | An | V.Drejtues kabllosh | cope | 1.0 | 1,000.0 | 1,000.0 |
| 11 | An | V.Panel 2 ventilator 19" me termostat | cope | 1.0 | 1,200.0 | 1,200.0 |
| 12 | An | V.Patch corda me FTP-cat-6 me dy koka konektoriale, L=2 m | cope | 10.0 | 1,300.0 | 13,000.0 |
| 13 | An | V.Suport 8 priza PDU 19" 1HE 16A | cope | 1.0 | 500.0 | 500.0 |
| 14 | An | V.Kompjuter PC i kompletuar me Monitor 22 " per menaxhimin e sistemeve | cope | 1.0 | 2,000.0 | 2,000.0 |
| 15 | An | V.Central zjarri konveksional | set | 1.0 | 10,000.0 | 10,000.0 |
| 16 | An | V.Buton per thirrje manuale I adresueshem | cope | 2.0 | 2,000.0 | 4,000.0 |
| 17 | An | V.Bateri 12V 7,2Ah | cope | 2.0 | 1,000.0 | 2,000.0 |
| 18 | An | F.V.Kabell per sistem zjarri me izolim G4 ,S=2x1 mm², Ngjyre e Kuqe | ml | 140.0 | 250.0 | 35,000.0 |
| 19 | An | V.Ushqyes 230/24 VDC 100 W | cope | 1.0 | 1,200.0 | 1,200.0 |
| 20 | An | V.Njesia qendrore e kontrrollit | cope | 1.0 | 1,500.0 | 1,500.0 |



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

ELBASAN

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | An | F.V Termostat per rack | cope | 1.0 | 1,320.0 | 1,320.0 |
| 22 | An | F.V.:NVR (Network Video Recorder), me 16 kanale, 1U, 19" per montim ne rack, (Programim, testim &komisionim i sistemit te vezhgimit CCTV) | cope | 1.0 | 12,500.0 | 12,500.0 |
| 23 | An | V.Njesia transmetuese per 4 gjuhe perkthimi | cope | 1.0 | 2,000.0 | 2,000.0 |
| 24 | An | V.Radiator transmetimi per hapsira deri ne 1000m2 | cope | 1.0 | 3,500.0 | 3,500.0 |
| 25 | An | V.Marres sinjali portabel me akses ne 4 gjuhe transmetimi | cope | 120.0 | 500.0 | 60,000.0 |
| 26 | An | V.Bateri e rikarikueshme per marresit portabel te sinjalit | cope | 120.0 | 400.0 | 48,000.0 |
| 27 | An | V.Kufje te lehta per marresit portabel | cope | 120.0 | 200.0 | 24,000.0 |
| 28 | An | V.Njesi karikimi per marresa portabel me kapacitet karikimi deri ne 56 marres njekohesisht | cope | 1.0 | 1,000.0 | 1,000.0 |
| 29 | An | V.Ndares sinjali (Spliter) me 4 porta dhe mbrojtie nga lidhjet e shkurtra te integruar per te gjitha daljet | cope | 3.0 | 1,200.0 | 3,600.0 |
| 30 | An | V.Njesi diskutimi me mundesi perdorimi nga 1 ose 2 delegate | cope | 3.0 | 1,000.0 | 3,000.0 |
| 31 | An | V.Butona per kontrroll te pavarur njesi folese nga 2 delegate | cope | 1.0 | 1,000.0 | 1,000.0 |
| 32 | An | V.Kornize per njesite e diskutimit | cope | 1.0 | 1,000.0 | 1,000.0 |
| 33 | An | V.Njesi perkthimi me mundesi deri ne 31 kanale te ndryshme transmetimi | cope | 4.0 | 2,000.0 | 8,000.0 |
| 34 | An | V.Mikrofon per montim ne njesite e dikutimit/perkthimit me gjatesi 48cm | cope | 2.0 | 1,200.0 | 2,400.0 |
| 35 | An | V.Mikser audio me 6 inpute nga te cilat 2 prioritare me opsion VOX | cope | 1.0 | 1,300.0 | 1,300.0 |
| 36 | An | V.Marres valesh ne brezin e frekuencave 606-630 MHz | cope | 2.0 | 1,500.0 | 3,000.0 |
| 37 | An | V.Marres valesh ne brezin e frekuencave 722-746 MHz | cope | 1.0 | 1,600.0 | 1,600.0 |
| 38 | An | V.Kit per fiksimin e njesive marrese te valeve ne Rack 19" | cope | 3.0 | 1,000.0 | 3,000.0 |
| 39 | An | V.Mikrofon dore me vale ne brezin e frekuencave 606-630 MHz | cope | 2.0 | 1,000.0 | 2,000.0 |
| 40 | An | V.Mikrofon dore me vale ne brezin e frekuencave 722-746 MHz | cope | 2.0 | 1,000.0 | 2,000.0 |
| 41 | An | V.Amplifikator Plena 480W ose ekuivalent | cope | 1.0 | 1,000.0 | 1,000.0 |
| 42 | An | V.Bokse audio kolone me karkase metalike me fuqi max 60W | cope | 6.0 | 500.0 | 3,000.0 |
| 43 | An | F.V.Fish rrjeti per lidhjen e njesis DCN me integruesin 5m | cope | 1.0 | 200.0 | 200.0 |


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

ELBASAN

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 44 | An | F.V.Fish audio DCN me gjatesi 20m | cope | 2.0 | 1,000.0 | 2,000.0 |
| 45 | An | F.V.Fish audio DCN me gjatesi 2m | cope | 9.0 | 1,000.0 | 9,000.0 |
| 46 | An | F.V.Fish RG59 per lidhjen e integratorit me radiatorin 20m | cope | 1.0 | 1,000.0 | 1,000.0 |
| 47 | An | F.V.Fish audio XLR | cope | 2.0 | 1,000.0 | 2,000.0 |
| 48 | An | V. Kuadri Kryesor sipas standarteve | set | 1.0 | 1,000.0 | 1,000.0 |
| 49 | An | F.V. Tub fleksibel PVC,djegje pa flake dhe emetim gazi, Ø20mm me aksesore | ml | 70.0 | 1,000.0 | 70,000.0 |
| 54 | An | V.Perde projektori e motorrizuar e kompletuar me kabell furnizimi 20m | cope | 1.0 | 1,000.0 | 1,000.0 |
| 55 | An | V.Projektor profesional | cope | 4.0 | 1,000.0 | 4,000.0 |
| 56 | An | F.V. Kuti per pajisje 12M dysheme (Plana/ekuivalent) | cope | 3.0 | 1,000.0 | 3,000.0 |
| 57 | An | F.v. Perde elektrike per projektor me pult komandimi 240 cm x 200 cm | cope | 1.0 | 1,000.0 | 1,000.0 |
| | | **Shuma A-5** | | | | **392,570.0** |
| A-6 | | **RRJETI I DETEKTIMIT TE ZJARRIT** | | | | |
| 1 | An | V Central i alarmit te zjarrit, me 2 loop, tip inteligjent, i adresueshem, me regjistrim ngjarjesh, modul komunikimi, grafik karte, me porte kompjuterike, i programueshem, i pajisur me bateri me 72 ore pavaresi (Programim, testim & komisionim i sistemit te detektimit te zjarrit) | cope | 1.0 | 321,000.0 | 321,000.0 |
| 2 | An | F.V Detektore tymi , i adresueshem | cope | 3.0 | 4,200.0 | 12,600.0 |
| 3 | An | F.V Pulsant manual alarmi zjarri (me thyerje xhami), adresueshem, IP-40 | cope | 1.0 | 2,800.0 | 2,800.0 |
| 4 | An | F.v. Llampe ripetitor LED | cope | 1.0 | 3,520.0 | 3,520.0 |
| 5 | An | FV - Ripetitor drite LED e kuqe per dedektoret mbi tavan | cope | 1.0 | 2,500.0 | 2,500.0 |
| 7 | An | V.Detektor optik tymi konveksional brenda tavanit | cope | 4.0 | 3,200.0 | 12,800.0 |
| 8 | An | V.Detektor optik tymi konveksional jashte tavanit | cope | 4.0 | 3,200.0 | 12,800.0 |
| 9 | An | F.V Sirena alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te brendshem, tip inteligjent te adresuesheme, me intesitet 120dB. | cope | 1.0 | 6,500.0 | 6,500.0 |
| 10 | An | F.V Sirena alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te jashtem, tip inteligjent te adresuesheme, me intesitet 120dB. | cope | 1.0 | 6,200.0 | 6,200.0 |


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | An | F.V Kabllo i kuq alarmi zjarri, rezistent ndaj zjarrit S=2x1mm2, tipi FG40HM1, PH.30min | ml | 300.0 | 250.0 | 75,000.0 |
| 12 | An | F.V Kuti shperndarese , montim jashte murit PT-2-5, IP40 | cope | 10.0 | 1,500.0 | 15,000.0 |
| 13 | An | FV - Sensor IR me shfaqje, te montuar ne tavan te varur, 230V AC 1000W. | cope | 1.0 | 3,250.0 | 3,250.0 |
| 14 | An | V.Bateri 12V 7,2Ah | cope | 3.0 | 5,000.0 | 15,000.0 |
| | | **Shuma A-6** | | | | **488,970.0** |
| **A-7** | | **KONDICIONIM & APIRIMI (MONTIM)** | | | | |
| 1 | An | V.Pajisje e jashtme kondicionimi pompe nxehtesie te tipit ***VRF INVERTER*** e kompletuar me degezuesin dhe gjithcka te nevojsme gati per montim . Kapaciteti nominal ftohje/ngrohje Q = 16.1 KW . | cope | 1.0 | 15,000.0 | 15,000.0 |
| 2 | An | V.Pajisje e brendshme kondicionimi te tipit ***VRF TAVANORE INVERTER*** e kompletuar me grile dhe gjithcka te nevojsme per montim.Kapaciteti nominal Q= 7.1KW. ( tavanore ) | cope | 2.0 | 5,000.0 | 10,000.0 |
| 3 | An | V.Rekuperator ajri i kompletuar me rezistence elektrike 8 kw. Prurje ajri 1200 mch presion statik 80PA. Ne cmim perfshihet komandimi I rekuperatorit dhe rezistences elektrike. | cope | 1.0 | 12,000.0 | 12,000.0 |
| 4 | An | F.V.Pult komandimi mural per njesite e brendshme. | cope | 2.0 | 12,500.0 | 25,000.0 |
| 5 | An | F.V Pulte qendror komandimi | cope | 1.0 | 7,500.0 | 7,500.0 |
| 6 | An | F.V.Degezues me kod "Y" per fuqi ≤29kw | cope | 4.0 | 4,500.0 | 18,000.0 |
| 7 | An | F.V.Tubacione bakri te termoizoluara per gaz R410 Φ6.4mm | ml | 15.0 | 650.0 | 9,750.0 |
| 8 | An | F.V.Tubacione bakri te termoizoluara per gaz R410 Φ12.7mm | ml | 45.0 | 750.0 | 33,750.0 |
| 9 | An | F.V.Tubacione bakri te termoizoluara per gaz R410 Φ15.9mm | ml | 25.0 | 850.0 | 21,250.0 |
| 10 | An | F.V.Tubacione bakri te termoizoluara per gaz R410 Φ28.6mm | ml | 8.0 | 950.0 | 7,600.0 |
| 11 | An | F.V.Kabell komunikimi 2x1 mm2 | ml | 55.0 | 220.0 | 12,100.0 |
| 12 | 2.491/c | F.V.Tubacione shkarkimi Φ32 mm | ml | 40.0 | 260.0 | 10,400.0 |
| 13 | An | F.V.Gaz R410 DuPont | kg | 5.0 | 1,350.0 | 6,750.0 |
| 14 | An | F.V.Tubacione llamarine te termoizoluar | kg | 520.0 | 325.0 | 169,000.0 |
| 15 | An | F.V.Grile alumini me 2RR40x15 per futjen dhe heqien e ajrit te paster. | cope | 8.0 | 4,800.0 | 38,400.0 |


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | An | F.V.Grila shiu per futjen e ajrit te paster me filter dhe mentesh 50x30 | cope | 1.0 | 4,200.0 | 4,200.0 |
| 17 | An | F.V.Tub flexibel I termoizoluar Φ200 | ml | 25.0 | 250.0 | 6,250.0 |
| 18 | An | F.V.Tub flexibel I termoizoluar Φ150 | ml | 25.0 | 320.0 | 8,000.0 |
| 19 | An | F.V.Aksesore te ndryshem montimi | komplet | 1.0 | 12,500.0 | 12,500.0 |
| | | **Shuma A-7** | **Leke** | | | **427,450.0** |
| | | **Shuma Totale pa paisje ( A1 - A7)** | | | | **6,660,120.0** |
| | | **Fondi rezerv 3 %** | | | | **199,803.6** |
| | | **Shuma Totale** | | | | **6,859,923.6** |
| | | **T.V.SH . 20 %** | | | | **1,371,984.7** |
| | | **TOTALI PUNIMEVE ME TVSH 20 %** | | | | **8,231,908** |
| **B-1** | | **FURNIZIM PAISJE ( me TVSH )** | | | | |
| 1 | An | F.UPS 3kVA | cope | 1.0 | 135,000.0 | 135,000.0 |
| 5 | An | F.Perde projektori e motorrizuar e kompletuar me kabell furnizimi 20m | cope | 1.0 | 25,000.0 | 25,000.0 |
| 6 | An | F.Projektor profesional | cope | 1.0 | 35,000.0 | 35,000.0 |
| 7 | An | F.Mbajtese tavanore projektori profesional | cope | 1.0 | 6,500.0 | 6,500.0 |
| 8 | An | F.Kabinet RACK19;32HE 600x800x1500 NE i kompletuar me aksesore si shina , rrota , vida etj. | cope | 1.0 | 55,000.0 | 55,000.0 |
| 9 | An | F.Switch 12P 10/100/1000 Mbps POE | cope | 1.0 | 32,500.0 | 32,500.0 |
| 10 | An | F.Pajisje Access-Point Wireless i Menaxhueshem | cope | 2.0 | 25,000.0 | 50,000.0 |
| 11 | An | F.Patch panel me 12 porta RJ-45, FTP cat 6 | cope | 1.0 | 12,500.0 | 12,500.0 |
| 12 | An | F.mbajtese kabllosh 1 U | cope | 1.0 | 5,000.0 | 5,000.0 |
| 13 | An | F.Panel 2 ventilator 19" me termostat | cope | 1.0 | 11,000.0 | 11,000.0 |
| 14 | An | F.Patch corda me FTP-cat-6 me dy koka konektoriale, L=2 m | cope | 15.0 | 3,000.0 | 45,000.0 |
| 15 | An | F.Suport 8 priza PDU 19" 1HE 16A | cope | 1.0 | 9,500.0 | 9,500.0 |
| 16 | An | F.Kompjuter PC i kompletuar me Monitor 22 " per menaxhimin e sistemeve | cope | 1.0 | 75,000.0 | 75,000.0 |
| 17 | An | F.Central Zjarri konveksional me 2 zona | set | 1.0 | 125,000.0 | 125,000.0 |
| 18 | An | F.Detektor optik tymi konveksional brenda tavanit | cope | 4.0 | 4,500.0 | 18,000.0 |
| 19 | An | F.Detektor optik tymi konveksional jashte tavanit | cope | 4.0 | 4,200.0 | 16,800.0 |
| 20 | An | F.Flashues LED, per sensor te fshehur | cope | 1.0 | 2,950.0 | 2,950.0 |
| 22 | An | F.Ushqyes 230/24 VDC 100 W | cope | 1.0 | 12,500.0 | 12,500.0 |
| 23 | An | F.Njesia qendrore e kontrrollit | cope | 1.0 | 13,500.0 | 13,500.0 |


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 24 | An | F.Njesia transmetuese per 4 gjuhe perkthimi | cope | 1.0 | 8,500.0 | 8,500.0 |
| 25 | An | F.Radiator transmetimi per hapsira deri ne 400 m2 | cope | 1.0 | 29,000.0 | 29,000.0 |
| 26 | An | F.Marres sinjali portabel me akses ne 4 gjuhe transmetimi | cope | 120.0 | 2,500.0 | 300,000.0 |
| 27 | An | F.Bateri e rikarikueshme per marresit portabel te sinjalit | cope | 120.0 | 2,000.0 | 240,000.0 |
| 28 | An | F.Kufje te lehta per marresit portabel | cope | 120.0 | 1,500.0 | 180,000.0 |
| 29 | An | F.Njesi karikimi per marresa portabel me kapacitet karikimi deri ne 56 marres njekohesisht | cope | 1.0 | 12,500.0 | 12,500.0 |
| 30 | An | F.Ndares sinjali (Spliter) me 4 porta dhe mbrojtje nga lidhjet e shkurtra te integruar per te gjitha daljet | cope | 3.0 | 23,000.0 | 69,000.0 |
| 31 | An | F.Njesi diskutimi me mundesi perdorimi nga 1 ose 2 delegate | cope | 3.0 | 10,000.0 | 30,000.0 |
| 32 | An | F.Butona per kontrroll te pavarur njesi folese nga 2 delegate | cope | 1.0 | 42,000.0 | 42,000.0 |
| 33 | An | F.Kornize per njesite e diskutimit | cope | 1.0 | 32,500.0 | 32,500.0 |
| 34 | An | F.Njesi perkthimi me mundesi deri ne 31 kanale te ndryshme transmetimi | cope | 4.0 | 15,000.0 | 60,000.0 |
| 35 | An | F.Mikrofon per montim ne njesite e dikutimit/perkthimit me gjatesi 48cm | cope | 2.0 | 16,200.0 | 32,400.0 |
| 36 | An | F.Mikser audio me 6 inpute nga te cilat 2 prioritare me opsion VOX | cope | 1.0 | 42,500.0 | 42,500.0 |
| 37 | An | F.Marres valesh ne brezin e frekuencave 606-630 MHz | cope | 1.0 | 55,000.0 | 55,000.0 |
| 38 | An | F.Marres valesh ne brezin e frekuencave 722-746 MHz | cope | 1.0 | 65,000.0 | 65,000.0 |
| 39 | An | F.Kit per fikisimin e njesive marrese te valeve ne Rack 19" | cope | 1.0 | 5,800.0 | 5,800.0 |
| 40 | An | F.Mikrofon dore me vale ne brezin e frekuencave 606-630 MHz | cope | 2.0 | 9,500.0 | 19,000.0 |
| 41 | An | F.Mikrofon dore me vale ne brezin e frekuencave 722-746 MHz | cope | 2.0 | 10,500.0 | 21,000.0 |
| 42 | An | F.Amplifikator Plena 480W ose ekuivalent | cope | 1.0 | 85,000.0 | 85,000.0 |
| 43 | An | F.Bokse audio kolone me karkase metalike me fuqi max 60W | cope | 4.0 | 12,500.0 | 50,000.0 |
| 44 | An | F.Kuader kryesor | cope | 1.0 | 135,000.0 | 135,000.0 |
| 45 | An | F.Pajisje e jashtme kondicionimi pompe nxehtesie te tipit ***VRF INVERTER*** e kompletuar dhe degezues, gjithcka te nevojshme gati per montim dhe venie ne funksionim. Kapaciteti nominal ftohje/ngrohje Q = 23-29 KW .( tavanore ) | cope | 1.0 | 1,750,000.0 | 1,750,000.0 |


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

| Nr. | Nr. An. | Emertimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 46 | An | F.Pajisje e brendshme kondicionimi te tipit ***VRF TAVANORE INVERTER*** e kompletuar me grile dhe gjithcka te nevojsme per montim dhe venie ne funksionim.Kapaciteti nominal Q= 7.1-8.02KW. | cope | 4.0 | 85,000.0 | 340,000.0 |
| 47 | An | F.Rekuperator ajri I kompletuar me rezistence elektrike 8 kw. Prurje ajri 1200 mch presion statik 80PA. Ne cmim perfshihet komandimi I rekuperatorit dhe rezistences elektrike. | cope | 1.0 | 225,000.0 | 225,000.0 |
| | | **SHUMA B-1** | **Leke** | | | **4,514,950** |
| | | **SHUMA TOTALE PUNIME** | | | | **8,231,908** |
| | | **SHUMA TOTALE PAJISJE** | | | | **4,514,950** |
| | | **SHUMA TOTALE PER ZBATIM** | | | | **12,746,858** |

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**
**ADMINISTRATORI**
**Eljan Hoxha**

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"INA" SHPK**
**ADMINISTRATOR**
**Ferdinand Caushi**



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

INA * Sh

Import Export

ALBANIA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**ADMINISTRATORI**

Nr. 1733/40 prot. Elbasan, me 09.08.2024

**KONTRATE PUBLIKE PËR PUNË**
**"Ndërtim i godinës së fakultetit të shkencave mjekesore teknike – FSHMT"**

E lidhur sot në datë 09.08.2024 në Universitetin "A.Xhuvani" Elbasan, mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, bazuar në dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit nr. 162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Rregullat e Prokurimit Publik", sipas kushteve të mëposhtme:

## A. KREU I: KUSHTET E VEÇANTA (Punë)

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

**Neni 1: Përkufizime**

- Autoriteti Kontraktor është - **Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani",** përfaqësuar nga Administratori **Eljan Hoxha,** njohur më poshtë si **"AUTORITETI KONTRAKTOR"** *(Blerësi Publik).*
- Kontraktuesi është – **"JUNIK" shpk,** me administrator **z. Ded Malutaj,** me adresë Lezhë: Lagjia "SMT" pranë Drejtorisë Shërbimi Pyjor Lezhë, rregjistruar më date 25.10.1995 , Nipt- **J68007522L,** dhe me liçencë NZ 1814/18 i cili përfaqëson këtë subjekt për detyrimet e kësaj kontrate i njohur më poshtë si **"Kontraktuesi"** *(shitësi).*

**Neni 2: Objekti i kontratës**

Mbi bazën e dokumentacionit që disponon, pas fitimit të prokurimit publik të zhvilluar në datë 31.01.2024, do të kryhen punimet e ndërtimit për objektin: "Ndërtim i godinës së fakultetit të shkencave mjekësore teknike – FSHMT", sipas kërkesave të projektit, volumeve të punës, specifikimeve teknike, termave të references etj, të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit të procedures së prokurimit me të njëjtin objekt, si dhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi në këtë procedurë prokurimi, sipas vleres së përcaktuar në nenin 5 dhe aneksin e kontratës.

**Neni 3: Hyrja në fuqi e kontratës**

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

ELBASAN

**Neni 4: Data e Fillimit**
Pavarësisht dispozitës së mësipërme: Kontraktorit do ti fillojë punimet me nënshkrimin e procesit "Aprovim" i Njoftimit të Fillimit të Punimeve nga bashkia Elbasan ( sipas njoftimit elektonik në platformën e –Albania ) dhe duhet ti përfundojë punimet maksimumi brenda 16 (gjashtëmbëdhjet) muajve nga data e Aprovimit të Njoftimit të fillimit të punimeve nga bashkia Elbasan.

**Neni 5: Çmimi i Kontratës**
Kjo kontratë do të çmohet si një:
- *Kontratë me Çmim Njësie* të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
- *Kontratë me Shumë Totale*

**Vlera totale kontratës** (pa tvsh) është **656,900,361.42** *(Gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtëmilion e nëntëqindmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një pikë dyzetë e tre)* lekë
**Vlera e plotë e kontratës** (me tvsh) që do ti paguhet kontraktuesit është **781,242,174** *(Shtatëqind e tetëdhjetë e njëmilion e dyqind e dyzetë e dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër)* Lekë.

**Neni 6: Kantieri**
Kantieri i Punëve do të jenë pasuria nr. 7/19/2 dhe pasuria nr. 7/215, e llojit " truall" në ZK 8525 në Fakultetin e Shkencave Mjekesore Teknike, trualli është në përgjegjësi administrimi të autoritetit kontraktor.

**Neni 7: Sigurimi i Kontratës**
Garancia e kontratës e paraqitur nga Kontraktuesi para lidhjes së kontratës, sipas modelit përkatës dhënë në dokumentat e tenderit ka vlerën 10% të vlerës së kontratës në shumën absolute 78,124,217 lekë. Kjo shumë do të garantojë autoritetin kontraktor për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi (shitësi).
Çlirimi i garancisë së kontratës do të bëhet me shkrim nga Blerësi Publik, 30 ditë pas përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi.

**Neni 8: Detyrimet e Kontraktorit**

8.1. Kontraktori do të kryej punimet në përputhje me projektin e dhëne nga Autoriteti Kontraktor dhe në zbatim të K.T.Z-të dhe K.T.P-të të RSH, specifikimet teknike të paraqituar në dokumenta e tenderit.

8.2. Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në project, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike të dhena nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rasteve kur gabimi është aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta reklamonte tek Autoriteti Kontraktor.

8.3. Nëse gjatë ekzekurimit të kontratës ka ndryshime në zbatim te kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

8.4. Drejtuesi Teknik i Punimeve në kantier është i detyruar të mbajë ditarin e objektit,process verbalet e punimeve, akt kontrollet e fazave të punimeve në objekt, librezën e masave ku të përfshihen të gjitha volume punimeve të kryera, urdhërat nga mbikqyrësi i punimeve ( Autoriteti kontraktor) për cdo problem në objekt. Ky dokumentacion në cdo kohë do ti vihet në dispozicion Mbikqyrësit të punimeve, grupit të kolaudimit dhe Autoritetit Kontraktor.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

ELBASAN

8.5. Kontraktori do të kryejë punime me nënsipërmarrje vetëm nëse Autoriteti Kontraktor e ka lejuar këtë në dokumenta e tenderit vetëm pasi të ketë marrë miratimin e Investiorit.
8.6. Kontraktori ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi.Gjithashtu të mos japë asnjë informacion (botime artikujsh apo skica ,fotografi) mbi ecurin e punimve pa lejen e Investiorit.
8.7. Kontraktori është i detyruar të marrë të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së ambientit duke përdoruar të gjitha mjetet ne dispozicion.
8.8. Kontraktori është i detyruar të rrethojë kantierin e punimeve të ndërtimit në datën e aprovimit të njoftimit të fillimit të punimeve, dhe hyrja në kantier të bëhet sipas standarteve të përcaktuara.
8.9. Kontratkori është i detyruar të lagë me ujë zonen e kantierit të punimeve të ndërtimit me qëllim eliminimin e ndotjes së mjedisit që rrjedhin nga kryerja e punimeve.
8.10. Kontraktori është i detyruar të pajisë me unifromë pune të gjithe personelin punëtor.Uniformat e punës duhet të kenë të evidentuar emrin e kontraktorit si dhe të jenë të pajisuar me shirita fosforime për tu dalluar natën.
8.11. Kontraktori është i detyruar të përdori mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.Këto mjete duhet të vendosen në mënyrë të dukshme për të gjithë.
8.12. Kontraktori është i detyruar të vendosë në kantier të gjitha makineritë dhe mjetet e paraqituar në ofertë, mbi bazë të së cilës është shpalluar fitues. Mjetet e qarkullimit duhet të janë të pajisuara me leje përkatëse.
8.13. Kontraktori nuk duhet të ndajë kantierin me firma të tjera , duhet të bashkëpunojë me autoritetet publike, shërbime publike dhe Autoritetin Kontraktor sic kërkohet dhe përkufizohet ne grafikun e realizimit të punimeve.
8.14. Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Mbikqyrësi i Punimeve për shqyrtim dhe miratim e tij.
8.15. Kontraktuesi merr përsipër të respektoj të gjitha rregullat e parashikuar ne Legjislacionin ne fuqi mbi funksionimin e kantierit të punimeve.

**Neni 9: Personeli i Kontratorit**

9.1. Kontratori është i detyruar të punësojë në kantier për kryrjen e funksioneve të parashikuar në programin e miratuar nga Mbikqyresi i Punimve vetëm personelin inxhinierik të deklaruar në ofertë.
9.2. Mbikqyresi i Punimeve do ti propozoj Autoriteti Kontraktor për të zëvendësuar personelin kryesor vetëm në qoftëse kulifikimet dhe aftësit e tyre të nevojshme janë më të ulëta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Kontratorit.
9.3. Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të propozojë largimin nga puna të një ose të disa personave nga personeli i sipërmarrësit. Për të realizuar këtë, ai i drejtohet me shkrim titullarit të shoqërisë sipërmarrëse, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standardeve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftësia, arbitrariteti në zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi të rënda.
9.4. Kontratori është i detyruar të caktojë Drejtorin Teknik. Drejtori Teknik është personi që Kontraktori ka përcaktuar në oferten e tij.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel.& fax: +355 542 52593, Web: www.ukel.al

Drejtuesit Teknik të objektit do të jetë Ing___________-___________ i përfshirë në licensën profesionale të shoqërisë leshuar nga Ministria e Infrastrukurës dhe Energjisë. Detyrat e Drejtori Teknik të Punimeve janë si më poshtë:

a. Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit.
b. Të jetë i paranishëm gjatë kohës së zbatimit të punimeve në kantier.
c. Të jetë i pranishëm dhe të përfaqësojë Kontraktorin në të gjitha kontaktet takimet zyrtare apo mbledhjet që Autoriteti Kontraktor zhvillon me Kontratorin dhe Drejtorin Teknik në zgjithjet e diskutimve e ceshtjeve teknike e profesionale që lindin gjatë zbatimit të kontratës.
d. Është përgjegjës për dokumentacionin Teknik që është i detyrushëm të mbahet ne object.
e. Mban korrespodencen zyretare me Mbikqyresin e Punimeve.
f. Është përgjegjës për ecurin e zbatimin të punimve conform plan organizimit dhe grafikut të punimve;
g. Është i pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.

9.5. Në rast se ndryshon Drejtuesei Teknik , Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë Mbikqyresin e Punimve i cili do të vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

9.6. Drejtuesi Teknik në këtë rast duhet të ketë të gjitha kulifikimet e kërkuara të dokumentat e tenderit për drejtuesin Teknik.Autoriteti Kontrakto mund të kundërshtoj emërimin e drejtuesit Teknik nëse vlereson se ai nuk i përmbush kulifikimet e percaktuara ne DST.Në këtë rast Kontraktori cakton një drejtues Teknik tjeter detyrimisht Mbikqyresin e Punimve i cili do të vë në dijeni Autoritetin Kontraktor

**Neni 10: Fillimi i zbatimit dhe mënyra e levrimit**

Grafiku i realizimit të punimeve është me afat 16 muaj **data e "Aprovimit" të njoftimit të fillimit të punimeve ( në sistemin e –Albania) nga bashkia Elbasan,** sipas Shtojcave 6 "Grafiku i Zbatimi të Punimeve" dhe Shtojcu 5 "Formulari i Specifikimeve Teknike" të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Pagesa për punët e kryera duhet bërë brenda 30 ditëve nga dita që sipërmarrësi (Blerësi Publik) paraqet faturën tatimore të shoqëruar me situacionin përfundimtar dhe dokumentacionet për punimet e kryera si dhe pas paraqitjes së raportit të drejtuesit të projektit (mbikëqyrësit të punimeve) me proces verbalin e marrjes në dorezim të punimeve nga investitori.

**Neni 11: Kushtet e Pagesës**

Pagesa do të kryhet kundrejt paraqitjes së dokumentacionit justifikues (faturës) të rregullt, të pranuar nga autoriteti kontraktor, **brenda 1 (një) muaji** nga dita e paraqitjes së dokumentit. Monedha me të cilën do të bëhet pagesa është **Lek.** Numri i llogarisë bankare të Kontraktuesit është në: **Banka Kombëtare Tregtare**, në llogarinë e subjektit **"JUNIK"** shpk me **IBAN:** [redacted] Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

Referuar kushteve dhe kritereve të DST ku rezultuar se Autoriteti Kontraktor: Nuk ka të parashikuar pagesë paraprake

**Neni 12: Siguracioni**

Nga data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion për objektin me vlerë totale: lekë me emra të përbashkët të investitorit dhe kontraktorit, data e hyrjes në kantier


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

deri në datën e realizimit të plotë të ndërtimeve, për humbjen ose demtimin e ndërtimeve; dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve ; dëmtime ose humbje të Pajisjeve ; dëmtime ose humbje të pasurise përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve; dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier.

**Neni 13: Inspektimet dhe Testimet**

Materialet që vijnë në kantier duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike të projektit. Materialet në vepër përdoren vetëm për miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Materialet e ardhura, si dhe pajisjet e siguruara nga sipërmarrësi, por që nuk pranohen nga mbikëqyrësi, zëvendësohen me të tjera, me shpenzimet e sipërmarrësit. Në këto raste (si për materialet, ashtu dhe për pajisjet) mospranimi duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standardeve të detyrueshme shqiptare ose atyre europiane.

Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave të materialeve të vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesës së lëndës së parë të furnizuar, për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit. Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit, në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

Mbikëqyrësi ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e investitorit, për aq kohë sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes.

**Neni 14: Pronësia Intelektuale**

14.1. Të drejtat e pronësisë intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do ti përkasin Autoriteti Kontraktor i cili do ti përdor sipas gjykimit të tij.

14.2. Kontraktori pas përfundimit të kontratës duhet ti dorëzoj Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si harta,skicime, specifikimet planet llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara mbledhura ose të përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës.Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave por nuk mund ti përdor për qëllimi që skanë lidhje me kontratën pa lejen me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

14.3. Kontraktor duhet të garantoj Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga pordorimi I materialve skiçave ose cdo pronë tjeter sipas kontratës.

14.4. Në rast se ngrihet njonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi I kontratës ose nga pordorimi I materialve, skicaveose cdo pronë tjetër të mbrojur e të durnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'I japë Autoriteti Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi ose pretendim

**Neni 15: Pasuria**

Të gjitha punimet e kryera dhe materialet e përdorura për realizimin e objektit do të konsiderohen si pronë e Autoritet Kontraktor në rast prishje kontrate.

**Neni 16: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

16.1. Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjesi për konkluzionet ose interpetimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit ( Inspektoriatet Shtetërore).

16.2. Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e punimeve dhe ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë .

**Neni 17: Preventivi**

17.1. Kontrata përfshin një preventiv për volume dhe cmime/njësi. Preventivi do të përfshijë të gjitha zërat e punimeve me cmimet përkatëse të parashikuara në ofertë .

17.2. Preventivi do të përdoret për të llogaritur vleren totale të kontratës.Kontraktori paguhet me sasinë e punës faktik të kryer sipas projektit të dhënë për zbatim, bazuar për cdo zë pune të preventivit me cmimin në njësi për secilin zë punimesh.

17.3. Për zërat e reja të paparashikuar në preventive, përvec dokumentacionit përkatës paraqitet edhe analiza teknike e cmimeve, për cdo zë të ri pune e cila i paraqitet Mbikqyerësit të Punimeve nga Kontraktori, Mbikqyresi i Punimeve pasi bën kontrollin e analizës teknike të cmimit ia çon për miratim Autoriteti Kontraktor. Mbas marrjes se miratimit nga Autoriteti Kontraktor, kontraktori ka për detyrë zbatimin e tij.

17.4. Nën/zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë cmim për njësi ne ofertë e paraqitur, do të konsiderohen si të mbuluara nga vlera e tjera të përfshira në kontratë.

**Neni 18: Negociata dhe Amendamentet**

18.1. Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftushëm kushtet që kanë përbër bazën e perzgjdhjes së Kontraktorit

18.2. Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë dhe u referuat shprehimisht kontratës.Cdo shtesë ose ndryshim amendamenti do të jetë I vlefshëm vetem në rast se nënshkruhet nga të dyja palët ose persona të autorizuar ne prokurë prej tyre.

18.3. Cdo heqje dorë nga e drejta pushtete ose ndreqjet qe mund të bëhen nga palët sipse kontratës duhet të bëhen me shkrim, në të cilen të specifikohet data dhe të nënshkruhet nga pala ose persona të autorizuar ne prokurë prej tyre që bën këtë dorëheqje dhë duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilen ajo leshohet.

**Neni 19: Ndryshimi i pronësisë**

19.1. Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës dyhet të bëhet me shkrim dhe nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

19.2. Ndërtime shtesë mund të porositen vetëm në rrethana të përcaktuara në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit original të kontratës.

19.3. Autoriteti Kontraktor mund që në çdo kohë të porosisë Kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës sa më poshtë vijon:
- Korrigjime në skicimin, vizatimin ose specifikimet e Ndërtimeve.
- Korrigjime në material.
- Korrigjime në sasi.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

19.4. Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në skedimin e dorëzimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi.Porosia e ndryshuar duhet të trupëzojë amendamentet e marrëveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshesshjes.

19.5. Çdo ndryshim i urdhëruar nga Investitori, do të jetë objekt i një process-verbali (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Investitori.Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Investitorit dhe në bazë të llogarive përkatëse të bëra nga Kontraktori dhe Mbikqyrësi i punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune shprehur në preventiv.

19.6. Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi pregatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohen zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si edhe për të gjetur burimet e financimit.

19.7. Nëse volume përfundimtare të punimeve të kryera, ndryshojnë nga volumet në preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit dhe fondit rezervë të parashikuar në preventive, Autoriteti Kontraktor ngarkon Mbikqyrësin e Punimeve për të sistemuar volume dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato.

**Neni 20: Programi**

20.1. Brenda 5 ditëve nga fillimi i efekteve teknike dhe financiare të kontratës kontraktori do ti paraqesë për miratim Mbikqyrësit të punimeve një program, në të cilin tregohet mënyra e kryerjes së punimeve dhe grafiku kohor. Kontraktori do të realizojë programin sipas grafikut të parashikuar. Kontraktori ka të drejtë t'i propozojë Mbikqyrësit të punimeve ndryshime në grafikun e punimeve duke i motivuar ato. Në këtë rast Mbikqyrësi i punimeve miraton ndryshime në program vetëm nëse ky ndryshim nuk do të ndikonte në afatin e realizimit të punimeve. Mbikqyrësi i Punimeve mund të kërkojë rishikimin e grafikut të punimeve për të përshpejtuar realizimin e tyre gjatë realizimit të punimeve.

20.2. Në rast se mund ose lind nevoja e dorëzimit të pjesshëm të punimeve këto parashikohen në grafikun e punimeve ose në ndryshimet e propozuara dhe të miratuara nga investitori.

20.3. Kontraktori duhet paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

**Neni 21: Korrigjimi i Difekteve**

21.1. Sa herë që gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve, nga mbikqyrësi I punimeve (Autoriteti Kontraktor) konstatohet një defekt Kontraktori është i detyruar ta korrigjojë atë Brenda afatit që i lihet me shkrim por jo më vonë se 30 ditë. (Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim

të sipërmarrësit, në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve).

21.2. Gjatë periudhës së garancisë së punimeve Autoriteti Kontraktor do të njoftojë Kontraktorin lidhur me çdo difekt para mbarimit të kësaj periudhe. Për eliminimin e difekteve lihet një afat i cili saktësohet sipas çdo rasti konkret por jo më shumë se 30 ditë.

21.3. Periudha e garancisë për difektet është afati 12 muaj. Me përfundimin e kësaj periudhe Kontraktori paraqit kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila i është mbajtur nga Investitori. Ky i fundit, brenda 10 ditëve organizon vizitën në terren ku kontrollohen realizimet e detyrave të lëna nga korigjimi i difekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Në se janë kryer të gjithë korrigjimet e difekteve atëhere hartohet akti përkatës i marrjes në dorëzim të objektit dhe që shënon përfundimin e detyrimeve reciproke të kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të mbikqyrjes së punimeve.

21.4. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoritetit Kontraktor.

**Neni 22: Difektet e Pakorrigjuara**

22.1. Në qoftë se Kontraktori nuk korigjon difektet e konstatuara në periudhën e garancisë së difekteve, brenda afatit të përcaktuar, Autoriteti Kontraktor do të vlerësojë koston e korrigjimit të difektit, dhe Kontraktori do të paguajë këtë shumë, së bashku me një gjobë të veçantë e cila do të jetë 0.04 % të vlerës së kontraktuar për çdo ditë vonesë. Autoriteti Kontraktor do ta mbajë këtë shumë duke e zbritur nga garancia e difekteve për punimet e cila është mbajtur progresivisht në situacione.

22.2. Në se me përfundimin e periudhës së garancisë Kontraktori nuk ka korrigjuar difektet e konstatuara Autoriteti Kontraktor zbret nga garancia deri në konfiskimin e krejt garancisë së punimeve.

**Neni 23: Situacionet**

23.1. Kontraktori do t'i parqesë Mbikqyrësit të punimeve brenda 5 ditëve të para të çdo muaji situacionet mujore progresive për punimet e kryera, duke zbritur pagesat e situacioneve të më parshme, garancitë e difekteve, paradhënien etj., të kësaj natyre, sikurse përcaktohet në këtë kontratë.

23.2. Mbikqyrësi i Punimeve do të kontrollojë punën e kryer nga Kontraktori dhe do të vërtetojë shumën që duhet t'i paguhet Kontraktorit Brenda 20 ditëve nga paraqitja e situacionit. Gjatë kontrollit Mbikqyrësi përcakton vlerën e punimeve të kryera.

23.3. Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe të shprehura në preventive, vlerën e ndryshimeve dhe të rasteve të kompensuara.

**Neni 24: Rastet e Kompensuara**

24.1. Rastet e kompensuara për të cilat vonesa justifikohet do të konsiderohën si vijojnë:

a) Mbikqyrësi i Punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet) specifikimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan. Tel.& fax: +355 542 52593. Web: www.uesel.edu.al

b) Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon Kontraktorin për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat pas kryerjes së punimeve.
c) Autoritetet Publike ose Autoriteti Kontraktor shkaktojnë vonesa në lirimin e sheshit të ndërtimit për Kontraktorin.
d) Autoriteti Kontraktor vonon pa arsye lëshimin e çertifikatës së marrjes në dorëzim.

24.2. Kompensimi i rasteve të sipërpërmendura do të bëhet si vijon:
Për vonesat e përmenduar në pikat (a, b, c,d) Autoriteti Kontraktor do të njohë shtyrjen e datës së përfundimit të punimeve mbi atë të parashikuar në këtë kontratë.

**Neni 25: Dëmshpërblimi për vonesat**

25.1. Kontraktori do t'i paguajë Investitorit dëmshpërblimin për vonesa në afatin e përfundimit të punimeve në masën 1/1000 në ditë të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total I kontratës, por kjo vlerës do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

25.2. Sasia e përgjithshme e dëmeve të likujduara nuk do të tejkalojë 25% të vlerës së Kontratës. Autoriteti Kontraktor do të zbresë dëmshpërblimin për vonesat nga pagesa e fundit e Kontraktorit.

25.3. Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit Nr.48/2014 "Për vonesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 26: Garancia e Difekteve**

Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës së kontratës që do ti mbahet nga çdo situacion Kontraktorit si garanci për cilësinë e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve (periudha e garancisë 12 muaj nga data e kolaudimit të punimeve), duke marrë parasysh edhe sanksionet e parashikuara në këtë kontratë.

**Neni 27: Kostoja e Riparimeve**

27.1. Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoren për punimet nga dita e fillimit deri në marrjen në dorëzim si dhe gjatë afatit të garancisë së difekteve do të mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij në qoftë se humbja ose dëmtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.

27.2. Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës, nëse janë për shkak të mosplotësimit të kontratës ose të punës jo cilësore të Kontraktorit do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

**Neni 28: Marrja në Dorëzim e Punimeve**

28.1. Kontraktori pas përfundimit të Punimeve njofton me shkrim Mbikqyrësin e Punimeve dhe Investitorin. Në se Mbikqyrësi nuk ka vërejtje ky njoftim shënon datën e përfundimit të punimeve. Kontraktori pas njoftimit të përfundimit të punimeve i paraqet brenda 30 ditëve Mbikqyrësit të Punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet përfundimtare për punimet e kryera. Mbikqyrësi i Punimeve mbas verifikimeve brenda 30 ditëve së bashku me relacionin e tij ia paraqet gjithë dokumentacionin Investitorit.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

28.2. Kontraktori duhet t'i kërkojë Mbikqyrësit të Punimeve t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e punimeve dhe mbikqyrësi i punimeve do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

28.3. Nëse mbikqyrësi i punimeve zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, mbikqyrësi i punimeve do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zërat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

28.4. Nëse mbikqyrësi i punimeve zbulon difekte në Punime, mbikqyrësi i punimeve duhet t'i japi kontraktorti njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

28.5. Mbas marrjes së gjithë dokumentacionit Autoriteti Kontraktor i paraqet komisionit të kolaudimit gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit. Me përfundimin e procedurave të kolaudimit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të çlirojë garancinë e sigurimit të Kontratës. Nga data e akt-kolaudimit të punimeve fillon periudha e garancisë së punimeve.

28.6. Në fund të periudhës së garancisë së punimeve, Mbikqyrësi i Punimeve dhe komisioni i marrjes në dorëzim të objektit do të përpilojë së bashku me Autoritetin Kontraktor aktin e marrjes në dorëzim të veprës, objekt i kësaj kontrate.

**Neni 29. Shërbimet në Lidhje me to**

Kushtet e veçanta të mëposhtme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura.

**Neni 30. Zbritja e garancisë së kontratës**

Nuk është parashikuar zbritje e garancisë së kontratës.

**Neni 31. Dokumentacioni dhe oferta**

Pjesë integrale dhe e pandarë e kësaj kontrate është oferta ekonomike si dhe gjithë dokumentacioni i projektit teknik mbi bazën e të cilit do të realizohet objekti i kësaj kontrate.

**Neni 32: Zgjidhja e kontratës**

Kontrata mund të zgjidhet duke pushuar çdo efekt të saj me njoftimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktor në rastet e mëposhtme :

1. Në rastin e mosrealizimit të punëve sipas kërkesës së autoritetit kontraktor pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.
2. Në rast mosplotësimi të kërkesave të realizimit të punëve objekt kontrate dhe mospranimit nga Kontraktuesi për zëvëndësimin e tyre me një punë tjetër njëlloj me të parën, që i përmbush këto kërkesa pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e mësipërm kontrata do të zgjidhet duke respektuar dispozitat e Kodit Civil.

**Neni 33: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Për çdo marrëveshje që mund të lind në zbatimin e kontratës, nëse ato nuk zgjidhen në marrëveshje midis palëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Shkallës së parë të Juridiksionit të përgjithshëm Elbasan.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

## Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**Neni 1: Dispozitat e përgjithshme**

1.1 **Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1.1. **Kontrata**

1.1.1.1."Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

1.1.1.2."Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

1.1.1.3."Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

1.1.1.4."Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

1.1.1.5."Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.

1.1.1.6."Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

1.1.1.7."Termat e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

1.1.1.8. "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

1.1.1.9. "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

1.1.1.10. "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.1.1.11. "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.1.2. **Palët e Kontratës**

1.1.2.1."Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Autoritetit kontraktor dhe Kontraktorit (realizuesit të punimeve)sipas kontekstit.

1.1.2.2."Kontraktori" do të thotë operatori (ët) ekonomik që do të realizojë punimet objekt kontrate.

1.1.2.3."Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

1.1.3. **Datat, Testet, Periudhat dhe Përfundimi**

1.1.3.1. "Test i materiale/pajisjeve" do të thotë testet (nëse janë të aplikueshme) të cilat janë specifikuar në Kontratë dhe që kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe





REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... "ALEKSANDËR XHUVANI" ... ELBASAN

legjislacionin e fushës, për qëllimin e përcaktimin të parametrave të materialeve/ pajisjve, para se të lejohet përdorimi/montimi/instalimi i tyre në objekt.

1.1.3.2."Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

1.1.4. **Punimet**

1.1.4.1. "Punime" do të thotë të gjitha proceset që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori për realizimin e objektit të kontratës. Përfshijnë gërmimin, ndërtimin, riparimin, rinovimin, instalimin, formatimit, testimin, zhvendosjen, transportin dhe çdo process që është parashikuara në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit

1.1.4.2."Shërbime të Lidhura" do të thotë shërbimet e rastit të lidhura me realizimin e proceseve, siç janë sigurimi, transporti, instalimi, vënia në punë, trajnimi dhe mirëmbajtja fillestare ose ndonjë shërbim tjetër i kësaj natyre sipas Kontratës.

1.1.5. **Përkufizime të tjera**

1.1.5.1. "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

1.1.5.2."Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 25 "Forca Madhore".

1.1.5.3."Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 10 "Sigurimi i Kontratës".

1.1.5.4. "Vendi i realizimit të kontratës" apo "kantieri", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

1.1.5.5."E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

1.1.5.6.Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 26.

1.1.5.7."Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.

1.1.5.8.Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

1.2 **Interpretimi**

**1.2.1. Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:**

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;
(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

**1.2.2. Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

**1.2.3. Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

ELBASAN

**1.2.4. Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

**1.3 Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK; dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa. Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

**1.4 Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë. Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

**1.5 Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

**1.6 Hartimi i Kontratës**

1.6.1. Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

1.6.2. Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

**1.7 E drejta e autorit**

1.7.1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

**1.8 Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Bleresi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

1.9 **Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Bleresi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Bleresit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Bleresit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Bleresi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Bleresit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Bleresit sipas pikës (a) te ketij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Bleresin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

1.10 **Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Bleresit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

1.11 **Inspektimet dhe Auditimi nga Bleresi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Bleresit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) ) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Bleresit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Bleresit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2: Praktikat e Ndaluara**



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52391, Web: www.uniel.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... ELBASAN

2.1. Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

2.2. Nëse Bleresi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Bleresi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3: Njoftimet**

3.1.Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

3.2.Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4: Objekti i Kontratës**

4.1.Punimet, materialet/pajisjet/produket dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të realizohen apo përdoren gjatë realizimit të kontratës duhet të jenë sipas specifikimeve teknike, projekteve përkatëse, termave të referencës apo detyrës së projektimit nëse është rasti,sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me stardardet teknike në fuqi.

4.2.Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Kontraktori, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5: Realizimi i punimeve**

5.1.Realizimi i të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyrë projektimi, nëse është rasti, si dhe i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me stardardet teknike në fuqi.

**Neni 6: Përgjegjësitë e Kontraktorit**

6.1.Kontraktori do të jetë përgjegjës për realizimi i të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyrë projektimi, nëse është rasti si dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në objektin e kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me standardet tenike në fuqi.

**Neni 7: Çmimi i Kontratës**

7.1.Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 19.

**Neni 8: Kushtet e Pagesës**

8.1. Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK. Furnizuesi dubet të paguhet nga Bleresi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

8.2. Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.
8.3. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.
8.4. Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 9 Tatimet, Taksat dhe Detyrimet e tjera**

9.1. Për materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës, të prodhuara jashtë vendit të Autoritetit Kontraktor, Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, taksat e pullës, tarifat e licencës dhe detyrime të tjera të tilla të vendosura jashtë vendit të Autoritetit Kontraktor
9.2. Për materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës, të prodhuara brenda vendit të Autoritetit Kontraktor Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, detyrimet, tarifat e licencës, etj., të lindura deri në realizimin e plotë dhe dorëzimin e objektit të kontratës, të Autoriteti Kontraktor
9.3. Nëse në vendin e Autoritetit Kontraktor mund të jetë i disponueshëm për Kontraktorin ndonjë përjashtim, ulje, lejim ose favor tatimor, Autoriteti Kontraktor duhet t'i krijojë mundës Kontraktorin të përfitojë nga këto lehtësira.

**Neni 10: Sigurimi i Kontratës**

10.1. Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.
10.2. Në përputhje me Nenin 11.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.
10.3. Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.
10.4. Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 11: Nënkontraktimi**

11.1. Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.
11.2. Autoriteti Kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për punet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Kontraktuesit.
11.3. Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 12: Specifikimet dhe Standardet**

12.1. Kontraktori duhet të sigurojë që punimet, Shërbimet e Lidhura, apo materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës, të jenë


Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

sipas specifikimeve teknike, projekteve përkatëse, termave të referencës apo detyrës së projektimit nëse është rasti, sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me stardardet teknike në fuqi.

12.2. Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekte, preventiv, detyrë projektimi, terma reference, ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktori duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoriteti Kontraktor për të

12.3. Kudo që bëhen referenca në Kontratë për kodet dhe standardet, në përputhje me të cilat do të ekzekutohet, shtesa ose versioni i rishikuar i kodeve dhe standardeve të tilla, do të jenë ato të specifikuara në kërkesat e dokumenteve të tenderit. Çdo ndryshim në cilindo kod dhe standard, gjatë ekzekutimit të Kontratës, do të zbatohet vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor i dhe do të trajtohet në përputhje me Nenin 26 të këtyre kushteve dhe dispozitat e LPP-së për modifikimin e Kontratës, Neni 127.

12.4. Kontraktori, në rast se evitohen mospërputhje apo mangësi në projekt-preventiv dhe kantier, brenda një afati të përcaktuar në kontratë, paraqet kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës.

12.5. Autoriteti Kontraktor administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të shqyrtohen në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

**Neni 13 Testimet dhe Inspektimet**

13.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës. Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose pregatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

13.2 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

13.3 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

13.4 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës

**Neni 14: Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

Përveç nëse specifikohet ndryshe në KVK, Kontraktuesi duhet të sigurojë punimet, Shërbimet e Lidhura, apo materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit të lidhur me realizimin, prodhimin ose blerjen, transportin, apo cdo procesi tjetër, në përputhje me Inkotermat e zbatueshme ose në mënyrën e specifikuar në KVK.

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "ALEKSANDER XHUVANI" ELBASAN

**Neni 15. Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

15.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

15.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 16: Zbulimet**

Çdo gjë me interes historik ose me vierë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen per te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhezimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve

**Neni 17: Disponimi i Kantierit**

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

**Neni: 18: Masat në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë.**

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet dhe Kontraktori duhet te sigurohen, që gjatëë zbatimit të kontratës të përmbushin detyrimet lidhur me kërkesat e sigurisë së shëndetit, punëve, ambientit për punët, apo nevojave për aftësi ose përvojë të specializuar mjedisore, sociale ose shëndetësore dhe të sigurisë, sikurse përcaktohet gjatë përgatitjes së dokumenteve të prokurimit.

18.2 Specialistët e sigurisë në punë, pjesë e stafit/personelit të Kontraktorit, duhet të disponojnë kualifikimet e parashikuara në legjislacionin e fushës, për marrjen e masave të e nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e sigurisë në punë, gjatë zbatimit të objektit të kontratës.

**Neni: 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.

19.2 Në intervale të skeduara rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

**Neni 20: Dëmet e likujduara**

Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:



Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 21 Garancia**

21.1. Kontraktori garanton se materialet/pajisjet/produktet e përdoruara gjatë realizimit të punimeve janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se sigurojnë përmirësimet e duhura të objektit të prokurimit, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë. Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se punimet apo materialet/pajisjet/produktet e përoruara gjatë realizimit të punimeve, nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi/zbatimi, cilësia e tyre në prodhim, apo nga puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

21.2. Autoriteti Kontraktor përcakton në KVK kohëzgjatjen e vlefshmërisë së garancisë (nëse është rasti), pasi punimet objekt kontrate, ose ndonjë pjesë e tyre sipas rastit, të jenë realizuar dhe marrë në dorëzim pas përfundimit të tyre.

21.3. Kontraktori do të njoftojë Autoritetit Kontraktor duke treguar natyrën e problemeve/defekteve të tilla së bashku me të gjitha provat e disponueshme të tyre, menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se dhjetë ditë nga zbulimi. Autoriteti Kontraktor do të sigurojë të gjitha mundësitë që Kontraktori të inspektojë defekte të tilla.

21.4. Pas marrjes së njoftimit, Kontraktori i duhet, brenda periudhës së specifikuar në KVK, të riparojë ose zëvendësojë me shpejtësi materialet/pajisjet/produktet ose pjesët e dëmtuara, pa ndonjë kosto për Autoritetit Kontraktor.
Nëse pas marrjes së njoftimit, Kontraktori nuk arrin të rregullojë defektin brenda periudhës së specifikuar më sipër, Autoriteti Kontraktor mund të kryejë rregullimet e nevojshme me shpenzimet e Kontraktorit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor mund të vendosë që të njoftojë Kontraktuesin për ndërprerjen e Kontratës.

**Neni 22: Zhdëmtimi i Patentës**

Kontraktori dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Autoriteti Kontraktor mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) Realizimit të punimeve apo instalimit të materialeve/pajisjeve/produkteve gjatë realizimit të objektit të kontratës. Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse materialet/pajisjet/produktet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese




ELBASAN

të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është paraqitur nga Kontraktori, në përputhje me Kontratën.

(b) Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Autoriteti Kontraktor që del nga çështjet e përmendura në Nenin 22.1, Bleresi do të njoftojë menjëherë Kontraktorin dhe Kontraktori mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Autoriteti Kontraktor të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

(c) Nëse Kontraktori nuk e njofton Autoritetin Kontraktor brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Autoritetin Kontraktor do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij. Autoriteti Kontraktor me kërkesën e Kontraktorit, do ti japë këtij të fundit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Kontraktori për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Autoriteti Kontraktor dëmshpërblen dhe zhdëmton Kontraktorin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Kontraktori mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo projekt, specifikim teknik, të dhënë, vizatim, apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Autoritetit Kontraktor

**Neni 23: Kufizimi i Përgjegjësisë**

Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

a) Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktor, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Kontraktroti për t'i paguar Autoritetit Kontraktor dëmet e likujduara;
Dhe

b) përgjegjësia e përgjithshme e Kontraktorit ndaj Autoritetit Kontraktor, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e riparimit ose zëvendësimit të materialet/pajisjet/produktet me defekt, ose çdo detyrim të Kontraktorit për të zhdëmtuar Autoritetit Kontraktor në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 24: Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

24.1. Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 25: Forca madhore**

25.1. Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

25.2. Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

25.3. Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore.

**Neni 26: Modifikimi i Kontratës**

26.1. Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

26.2. Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
b) Korrigjime në materiale
c) Korrigjime në sasi

26.3. Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

26.4. Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 27: Zgjatja e afatit**

27.1. Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

27.2. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit të Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

27.3. Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Kontraktori ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë realizimin në kohë të punimeve objekt kontrate në përputhje me Nenin 5, Kontraktori njofton menjëherë Autoritetit Kontraktor me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Kontraktorit, Autoritetit Kontraktor vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana eKontraktorit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

27.4. Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 25, një vonesë nga Kontraktori në kryerjen e detyrimeve të përfundimit sipas grafikut të punimeve

objekt kontrate do ta bëjë kontraktorin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

27.5. Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

**Neni 28: Ndërprerja e Kontratës**

28.1. **Njoftim për të korrigjuar.** Nëse Kontraktori nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Autoriteti Kontraktor mund ti kërkojë me Njoftim që të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

28.2. **Ndërprerja për mospërmbushje** Autoriteti Kontraktor pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Kontraktorit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë;

ose,

b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

c) Nëse provohet se Kontraktori është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

**Neni 29: Ndërprerja për paaftësi paguese**

29.1. Autoriteti Kontraktor ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Kontraktorin nëse Kontraktori falimenton. Kontraktori ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Autoriteti Kontraktor nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Kontraktorin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Autoritetin Kontraktor

**Neni 30: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

30.1 Autoriteti Kontraktor i mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

30.2 Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë me shkrim Kontraktorin për ndërprerjen.

30.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktorin për të gjitha punimet që janë marrë në dorëzim përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktorit dëmet e shkaktuara Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktorit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 31 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

31.1. Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

31.2. Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

**Kjo kontratë u përpilua në katër kopje duke u ndarë në tre kopje për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin.Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të të dyja palët, të cilët e firmosën dhe e vulosën atë respektivisht në çdo faqe.**

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**
**ADMINISTRATORI**
**Eljan Hoxha**

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"JUNUK" SHPK**
**ADMINISTRATOR**
**Ded Malutaj**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**ADMINISTRATORI**

# ANEKS KONTRATE
## "Ndërtim i godinës së fakultetit të shkencave mjekesore teknike – FSHMT"

| Nr. | Nr. Anal | Pershkrimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Çmimi pa TVSH | Vlera pa TVSH | TVSH | Vlera me TVSH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | | 1 - PUNIME PRISHJEJE | | | | | | |
| A-1 | | PUNIME PRISHJE | | | | | | |
| A-1.1 | 1.10 | Prerje e trungjeve me diameter ø 10 - 20 cm | cope | 4.0 | 147.96 | 591.8 | 118.4 | 710 |
| A-1.2 | Ana-1 | Çmontim i kangjellave metalike | m2 | 48.0 | 1,700.0 | 81,600.0 | 16,320.0 | 97,920 |
| A-1.3 | 2.426/6 | Prishje muri betoni/arme | m3 | 96.0 | 8,899.0 | 854,304.0 | 170,860.8 | 1,025,165 |
| A-1.4 | 2.426/3 | Prishje dysheme betoni | m3 | 180.0 | 6,143.0 | 1,105,740.0 | 221,148.0 | 1,326,888 |
| A-1.5 | Ana-2 | Prishje Tarracave dhe Bordurave Ekzistuese | m2 | 450.0 | 680.0 | 306,000.0 | 61,200.0 | 367,200 |
| A-1.6 | 3.197/1 | Prishje shtrese asfalti t = 15 cm, me makineri | m2 | 449.0 | 129.0 | 57,921.0 | 11,584.2 | 69,505 |
| A-1.7 | Ana - 3 | Prishje e linjave ekzistuese te KUZ | ml | 50.0 | 1,700.0 | 85,000.0 | 17,000.0 | 102,000 |
| A-1.8 | 2.37/3b | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km | m3 | 363.0 | 397.0 | 144,111.0 | 28,822.2 | 172,933 |
| | | **Shuma A-1** | | | | **2,635,267.8** | **527,053.6** | **3,162,321** |
| | | **SHUMA A (A-1)** | | | | **2,635,267.8** | **527,053.6** | **3,162,321** |
| B | | 2 - PUNIME NDERTIMI | | | | | | |
| B-1 | | PUNIME DHEU | | | | | | |
| B-1.1 | 2.28 | Germim themele e plinta h>2m, ekskavator me zinxhir 0.25m3, shkarkimi ne auto | m3 | 17,240.0 | 197.0 | 3,396,280.0 | 679,256.0 | 4,075,536 |
| B-1.2 | 2.19/a | Hedhje, mbushje, ngjeshje dheu me krah, kategoria IV | m3 | 865.0 | 393.00 | 339,945.00 | 67,989.00 | 407,934 |
| B-1.3 | 2.37/3b | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km | m3 | 16,375.0 | 397.0 | 6,500,875.0 | 1,300,175.0 | 7,801,050 |
| | | **Shuma B-1** | | | | **10,237,100.0** | **2,047,420.0** | **12,284,520** |
| B-2 | | PUNIME MURATURE | | | | | | |
| B-2.1 | 2.70/2 | Mur me tulle te lehtesuara deri 3m me llaç perzier M25 | m3 | 550.0 | 13,106.0 | 7,208,300.0 | 1,441,660.0 | 8,649,960 |
| B-2.2 | 2.239/a | Shtrese termoizoluese me polisterol t=3 cm | m2 | 1,815.0 | 2,385.00 | 4,328,775.00 | 865,755.00 | 5,194,530 |
| B-2.3 | 2.108/3+An | Ndertim muri me knauf t=12cm me dy shtresa, kunder lageshtires | m2 | 310.0 | 3,642.0 | 1,129,020.0 | 225,804.0 | 1,354,824 |
| B-2.4 | Ana - 4 | Termoizolim me lesh Guri, 8 cm (λ=0.037w/m k, R=1.35 m2 K/W) (Ndermjet mureve ndarese te sanitareve) | m2 | 310.0 | 1,275.0 | 395,250.0 | 79,050.0 | 474,300 |
| B-2.5 | 2.108/3+An | Ndertim muri me knauf t=25cm me dy shtresa, kunder lageshtires | m2 | 275.0 | 4,492.0 | 1,235,300.0 | 247,060.0 | 1,482,360 |

| Nr. | Nr. Anal | Pershkrimi i Punimeve | Njesia | Sasia | Çmimi pa TVSH | Vlera pa TVSH | TVSH | Vlera me TVSH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| B-2.6 | Ana - 5 | Termoizolim me lesh Guri, 10 cm (λ=0.037w/m.k, R=1.35 m2.K/W) (Ndërmjet mureve ndarës) | m2 | 2,435.0 | 1,275.0 | 3,104,625.0 | 620,925.0 | 3,725,550 |
| B-2.7 | 2.118/a+an | Ndërtim muri me knauf t=25cm me dy shtresa | m2 | 1,080.0 | 3,424.0 | 3,697,920.0 | 739,584.0 | 4,437,504 |
| B-2.8 | 2.119/1a.rev | Arkitrare b/a C20/25 | m3 | 1.7 | 19,643.0 | 33,393.1 | 6,678.6 | 40,072 |
| B-2.9 | 2.166.rev | F.V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (Arkitrare) | ton | 0.21 | 127,080.3 | 25,537.3 | 5,107.5 | 30,645 |
| | | **Shuma B-2** | | | | **21,158,120.4** | **4,231,624.1** | **25,389,744** |
| **B-3** | | **PUNIME KONSTRUKSIONI** | | | | | | |
| | | **I- Punime perforcim bazamenti (Pilotat)** | | | | | | |
| B-3.1 | 3.434 | Shpim me sonde Ø 0.8 m, ~ 15 m, (perde mbajtese) | m | 1,190.0 | 12,200.0 | 14,518,000.0 | 2,903,600.0 | 17,421,600 |
| B-3.2 | 3.An | Shpim me sonde "UKS" Ø 1 m, ~ 35 m, | m | 3,745.0 | 18,000.0 | 67,410,000.0 | 13,482,000.0 | 80,892,000 |
| B-3.3 | 3.244/1.rev | Mbushje me beton C 20/25 | m3 | 302.0 | 11,475.0 | 3,465,450.0 | 693,090.0 | 4,158,540 |
| B-3.4 | 3.243.rev | Struktura monolite betoni C 25/30 (pilotat Ø100cm) 35m | m3 | 2,873.0 | 11,000.0 | 31,603,000.0 | 6,320,600.0 | 37,923,600 |
| B-3.5 | 3.243.rev | Struktura monolite betoni C 16/20 (pilotat Ø80cm) 15m | m3 | 620.0 | 11,000.0 | 6,820,000.0 | 1,364,000.0 | 8,184,000 |
| B-3.6 | 3.243.rev | Struktura monolite betoni C 16/20 (Muri guidues për pilotat) | m3 | 195.0 | 11,000.0 | 2,145,000.0 | 429,000.0 | 2,574,000 |
| B-3.7 | 3.243.rev | Struktura monolite betoni C 25/30 (Trau në kokë të pilotave) | m3 | 98.0 | 11,000.0 | 1,078,000.0 | 215,600.0 | 1,293,600 |
| B-3.8 | Ana - 6 | F.V. Ankera me 5 gerdhata (F.V kavo celiku, vendosje e tubaje kontrolle, fabrikimi injektim cimentoje,tratim blokimi te ankerave, pjastra dhe bllokues pjastre) | ml | 1,437.0 | 15,000.0 | 21,555,000.0 | 4,311,000.0 | 25,866,000 |
| B-3.9 | 3.243.rev | Struktura monolite betoni C 25/30 (Trau në kokë të ankerave) | m3 | 208.0 | 11,000.0 | 2,288,000.0 | 457,600.0 | 2,745,600 |
| B-3.10 | Ana - 7 | Membrane Hidroizoluese Betonit | m2 | 1,205.0 | 2,500.0 | 3,012,500.0 | 602,500.0 | 3,615,000 |
| B-3.11 | 2.166.rev | F.V hekur betoni periodik Ø6-10 mm (për pilotat) | ton | 93.5 | 121,000.0 | 11,313,500.0 | 2,262,700.0 | 13,576,200 |
| B-3.12 | 2.167.rev | F.V hekur betoni periodik Ø>10 mm (për pilotat) | ton | 225.5 | 120,000.0 | 27,060,000.0 | 5,412,000.0 | 32,472,000 |
| B-3.13 | 2.167.rev | F.V hekur betoni periodik Ø>10 mm (për Mbushjen me Betonit) | ton | 17.8 | 120,000.0 | 2,136,000.0 | 427,200.0 | 2,563,200 |
| B-3.14 | 2.166.rev | F.V hekur betoni periodik Ø6-10 mm (për Traun e ankerave) | ton | 4.6 | 121,000.0 | 556,600.0 | 111,320.0 | 667,920 |
| B-3.15 | 2.167.rev | F.V hekur betoni periodik Ø>10 mm (për Traun e ankerave) | ton | 2.7 | 120,000.0 | 324,000.0 | 64,800.0 | 388,800 |
| | | **Shuma - I** | | | | **195,285,050.0** | **39,057,010.0** | **234,342,060** |
| | | **II - Punime betoni dhe b/a** | | | | | | |
| B-3.16 | An/2.116/1 | Pllake themeli b/a C - 30/37 me kristalizre (Objekti) | m3 | 1,720.0 | 14,010.0 | 24,097,200.0 | 4,819,440.0 | 28,916,640 |
17.1 Dëmet e likujduara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 18: Garancia**

**18.1** Furnizuesi garanton që Mallrat nuk kanë defekte që vijnë nga ndonjë veprim ose mosveprim i Furnizuesit ose që vijnë nga skicimi, materialet dhe punimi nën përdorimin normal në kushtet që mbizotërojnë në vendin e destinacionit përfundimtar.

**18.2** Blerësi përcakton në KVK kohëzgjatjen e vlefshmërisë së garancisë (nëse është rasti), pasi Mallrat, ose ndonjë pjesë e tyre sipas rastit, të jenë dorëzuar dhe pranuar në destinacionin përfundimtar të përshkruar në KVK.

**18.3** Blerësi do të njoftojë Furnizuesin duke treguar natyrën e defekteve të tilla së bashku me të gjitha provat e disponueshme të tyre, menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se dhjetë ditë nga zbulimi. Blerësi do të sigurojë të gjitha mundësitë që Furnizuesi të inspektojë defekte të tilla.

**18.4** Pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi duhet, brenda periudhës së specifikuar në KVK, të riparojë ose zëvendësojë me shpejtësi Mallrat ose pjesët e dëmtuara, pa ndonjë kosto për Blerësin.
Nëse pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi nuk arrin të rregullojë defektin brenda periudhës së specifikuar më sipër, Blerësi mund të kryejë rregullimet e nevojshme me shpenzimet e Furnizimit.
Në çdo rast, Blerësi mund të vendosë që të njoftojë Furnizuesin për ndërprerjen e Kontratës.

**Neni 19: Zhdëmtimi i Patentës**

**19.1** Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) instalimit të mallrave nga Furnizuesi ose përdorimit të mallrave në vendin e dorëzimit të Mallrave; dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Mallrat. Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Mallrat ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

**19.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 19.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

**19.3** Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Bleresi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.
Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.
Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

**Neni 20: Kufizimi i Përgjegjësisë**

**20.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara;

dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e riparimit ose zëvendësimit të pajisjeve me defekt, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 21: Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

**21.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 22: Forca madhore**

**22.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

**22.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

**22.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

**Neni 23: Modifikimi i Kontratës**

**23.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

**23.2** Blerësi mund t'i paraqesë kërkesë në çdo kohë Furnizuesit, të bëjë modifikime brenda objektit të përgjithshëm të Kontratës në një ose më shumë nga kushtet si vijon:

(a) vizatimet, skicat ose specifikimet, ku Mallrat që do të furnizohen sipas Kontratës duhet të prodhohen posaçërisht për Blerësin;
(b) mënyra e dërgesës ose paketimit;
(c) vendin e dorëzimit; dhe
(d) Shërbimet e Lidhura që do të ofrohen nga Furnizuesi.

**23.3** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

**23.4** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 24: Zgjatja e afatit**

**24.1** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë dërgimin në kohë të Mallrave ose përfundimin e Shërbimeve të Lidhura në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

**24.2** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 22, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

**Neni 25: Ndërprerja e Kontratës**

**25.1 Njoftim për të korrigjuar**

Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

**25.2 Ndërprerja për mospërmbushje**

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

(i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 25.1 të këtij neni;
(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të dorëzojë ndonjë ose të gjitha Mallrat brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 24;

ose

(iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

**25.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

**25.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

(a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

(b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

(c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Mallrat e pranuara dhe Shërbimet e lidhura me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve të lidhura me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 26: Kufizimet e Eksportit**

**26.1** Pavarësisht nga çdo detyrim sipas Kontratës për të përfunduar të gjitha formalitetet e eksportit, çdo kufizim eksporti që i atribuohet Blerësit, vendit të Blerësit ose përdorimit të mallrave ose shërbimeve që do të furnizohen, të cilat rrjedhin nga rregulloret tregtare nga një vend që furnizon ato mallra ose shërbime, dhe të cilat në mënyrë të konsiderueshme e pengojnë Furnizuesin për të përmbushur detyrimet e tij sipas Kontratës, do ta shkarkojnë Furnizuesin nga detyrimi për të ofruar dërgesa ose shërbime, gjithnjë me kusht që Furnizuesi të demonstrojë në mënyrë të kënaqshme për Blerësin që i ka përfunduar të gjitha formalitetet në kohën e duhur, duke përfshirë aplikimet për leje, autorizime dhe licenca të nevojshme për dërgimin e mallrave ose shërbimeve sipas kushteve të Kontratës.

**Neni 27: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**27.1** Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

**27.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

**Kjo kontratë u përpilua në katër kopje duke u ndarë në tre kopje për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin. Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të të dyja palët, të cilët e firmosën dhe e vulosën atë respektivisht në çdo faqe.**

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**
**ADMINISTRATORI**
**Eljan Hoxha**

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"TRINITY TRADE COMPANY" shpk**
**ADMINISTRATORI**
**Jashar Bajro**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
ADMINISTRATORI

**ANEKS KONTRATA - Blerja**

**"Blerje pajisje per krijimin e qenderes se simulimit te avancuar ne kuader te projektit kerkimor nga AKKSHI"**

| Nr | Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi pa Tvsh | Vlera pa TVSH | TVSH | Vlera me tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kompjuter laptop | copë | 2 | 222,000 | 444,000 | 88,800 | 532,800 |
| 2 | Monitor profesional | copë | 1 | 344,000 | 344,000 | 68,800 | 412,800 |
| 3 | Stereo amplifikator | copë | 1 | 208,000 | 208,000 | 41,600 | 249,600 |
| 4 | Audio mixer | copë | 1 | 422,000 | 422,000 | 84,400 | 506,400 |
| 5 | Radio dore dixhitale | copë | 1 | 97,000 | 97,000 | 19,400 | 116,400 |
| 6 | Banko tavoline | copë | 1 | 47,800 | 47,800 | 9,560 | 57,360 |
| 7 | Karrige me rrota | copë | 3 | 14,000 | 42,000 | 8,400 | 50,400 |
| 8 | Simulator i Avancuar i Lindjes me aksesorët përkatës - GAUMARD S2200 | set | 1 | 11,050,000 | 11,050,000 | 2,210,000 | 13,260,000 |
| 9 | Software për simulatorin e Avancuar të Lindjes | copë | 1 | 1,250,000 | 1,250,000 | 250,000 | 1,500,000 |
| 10 | Sistemi i trajnimit të realitetit të përzier (set me 2 copë) | set | 1 | 834,000 | 834,000 | 166,800 | 1,000,800 |
| 11 | Software për sistemin e traitimit të realitetit të përzier | copë | 1 | 428,000 | 428,000 | 85,600 | 513,600 |
| 12 | Monitor pacienti me prekje | copë | 2 | 194,000 | 388,000 | 77,600 | 465,600 |
| 13 | Pajisje Tablet për instruktorin | copë | 2 | 144,000 | 288,000 | 57,600 | 345,600 |
| 14 | Pajisje për ruajtjen e të dhënave të Hapësirës Mësimore | set | 2 | 1,442,000 | 2,884,000 | 576,800 | 3,460,800 |
| 15 | Kamera optike PTZ HD- Kamera e rrjetit | copë | 2 | 274,000 | 548,000 | 109,600 | 657,600 |
| 16 | Kamera dixhitale PTZ HD -Kamera e rrjetit | copë | 2 | 148,000 | 296,000 | 59,200 | 355,200 |
| 17 | Mikrofon i Hapësirës Mësimore | copë | 2 | 158,000 | 316,000 | 63,200 | 379,200 |
| 18 | Altoparlant | copë | 2 | 114,000 | 228,000 | 45,600 | 273,600 |
| 19 | Krevat pacienti ICU | copë | 2 | 234,000 | 468,000 | 93,600 | 561,600 |
| 20 | Dyshek krevati | copë | 2 | 27,400 | 54,800 | 10,960 | 65,760 |
| 21 | Mbajtëse monitor pacienti | copë | 2 | 93,600 | 187,200 | 37,440 | 224,640 |
| 22 | Ndarëse ambjenti mjekësor | copë | 2 | 46,000 | 92,000 | 18,400 | 110,400 |
| 23 | Karrocë emergjence | copë | 2 | 54,500 | 109,000 | 21,800 | 130,800 |
| 24 | Llampë ndricimi mjekësore | copë | 2 | 348,000 | 696,000 | 139,200 | 835,200 |
| 25 | Simulator i Avancuar i të rriturve me aksesorët përkatës - GAUMARD Hal S1000 | set | 1 | 5,610,000 | 5,610,000 | 1,122,000 | 6,732,000 |
| 26 | Software për simulatorin e avancuar të të rriturve | copë | 1 | 1,155,000 | 1,155,000 | 231,000 | 1,386,000 |
| 27 | Monitor 85 inch | copë | 1 | 420,000 | 420,000 | 84,000 | 504,000 |

Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al info@uniel.edu.al

| Nr | Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi pa Tvsh | Vlera pa TVSH | TVSH | Vlera me tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 28 | Tavolinë e instruktorit | copë | 1 | 31,000 | 31,000 | 6,200 | 37,200 |
| 29 | Tavolinë për studentët | copë | 10 | 18,200 | 182,000 | 36,400 | 218,400 |
| 30 | Karrige për instruktorin | copë | 1 | 18,000 | 18,000 | 3,600 | 21,600 |
| 31 | Karrige për studentët | copë | 20 | 7,500 | 150,000 | 30,000 | 180,000 |
| | **Shuma** | | | | **29,287,800** | **5,857,560** | **35,145,360** |

**ANEKS KONTRATA – Sipas llogarisë ekonomike të investimit**

| Nr | Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi pa Tvsh | Vlera pa TVSH | TVSH | Vlera me tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I | Shpenzime për "Paisje dhe instrumente laboratorike" - llogaria 2314140 | | | | 21,598,200 | 4,319,640 | 25,917,840 |
| 1 | Simulator i Avancuar i Lindjes - GAUMARD S2200 | set | 1 | 12,300,000 | 12,300,000 | 2,460,000 | 14,760,000 |
| 2 | Sistemi i trajnimit të realitetit të përzier | set | 1 | 1,262,000 | 1,262,000 | 252,400 | 1,514,400 |
| 3 | Simulator i Avancuar i të rriturve - GAUMARD Hal S1000 | set | 1 | 6,765,000 | 6,765,000 | 1,353,000 | 8,118,000 |
| 4 | Mbajtese dhe Monitor pacienti me prekje | copë | 2 | 287,600 | 575,200 | 115,040 | 690,240 |
| 5 | Llampë ndricimi mjekësore | copë | 2 | 348,000 | 696,000 | 139,200 | 835,200 |
| II | Shpenzime për "Orendi laboratori" - llogaria 2318100 | | | | 1,194,600 | 238,920 | 1,433,520 |
| 1 | Banko tavoline - Stimulimi | copë | 1 | 47,800 | 47,800 | 9,560 | 57,360 |
| 2 | Karrige me rrota - Stimulimi | copë | 3 | 14,000 | 42,000 | 8,400 | 50,400 |
| 3 | Krevat pacienti ICU - Stimulimi | copë | 2 | 234,000 | 468,000 | 93,600 | 561,600 |
| 4 | Dyshek krevati - Stimulimi | copë | 2 | 27,400 | 54,800 | 10,960 | 65,760 |
| 5 | Ndarëse ambjenti mjekësor - Stimulimi | copë | 2 | 46,000 | 92,000 | 18,400 | 110,400 |
| 6 | Karrocë emergjence - Stimulimi | copë | 2 | 54,500 | 109,000 | 21,800 | 130,800 |
| 7 | Tavolinë e instruktorit - Stimulimi | copë | 1 | 31,000 | 31,000 | 6,200 | 37,200 |
| 8 | Tavolinë për studentët - Stimulimi | copë | 10 | 18,200 | 182,000 | 36,400 | 218,400 |
| 9 | Karrige për instruktorin - Stimulimi | copë | 1 | 18,000 | 18,000 | 3,600 | 21,600 |
| 10 | Karrige për studentët - Stimulimi | copë | 20 | 7,500 | 150,000 | 30,000 | 180,000 |
| III | Shpenzime për "Paisje kompjuterike laboratori" - llogaria 2318600 | | | | 6,495,000 | 1,299,000 | 7,794,000 |
| 1 | Kompjuter laptop Lenovo - Stimulimi | copë | 2 | 222,000 | 444,000 | 88,800 | 532,800 |
| 2 | Monitor profesional - Stimulimi | copë | 1 | 344,000 | 344,000 | 68,800 | 412,800 |
| 3 | Stereo amplifikator- Stimulimi | copë | 1 | 208,000 | 208,000 | 41,600 | 249,600 |
| 4 | Audio mixer - Stimulimi | copë | 1 | 422,000 | 422,000 | 84,400 | 506,400 |
| 5 | Radio dore dixhitale - Stimulimi | copë | 1 | 97,000 | 97,000 | 19,400 | 116,400 |
| 6 | Pajisje Tablet për instruktorin - Stimulimi | copë | 2 | 144,000 | 288,000 | 57,600 | 345,600 |
| 7 | Pajisje për ruajtjen e të dhënave - Stimulimi | set | 2 | 1,442,000 | 2,884,000 | 576,800 | 3,460,800 |
| 8 | Kamera optike rrjeti (PTZ HD) - Stimulimi | copë | 2 | 274,000 | 548,000 | 109,600 | 657,600 |
| 9 | Kamera dixhitale rrjeti (PTZ HD) - Stimulimi | copë | 2 | 148,000 | 296,000 | 59,200 | 355,200 |
| 10 | Mikrofon i Hapësirës Mësimore - Stimulimi | copë | 2 | 158,000 | 316,000 | 63,200 | 379,200 |
| 11 | Altoparlant - Stimulimi | copë | 2 | 114,000 | 228,000 | 45,600 | 273,600 |
| 12 | Monitor 85 inch - Stimulimi | copë | 1 | 420,000 | 420,000 | 84,000 | 504,000 |
| | **Shuma** | | | | **29,287,800** | **5,857,560** | **35,145,360** |

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**
**ADMINISTRATORI**
**Elian Hoxha**

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"TRINITY TRADE COMPANY" shpk**
**ADMINISTRATORI**
**Jashar Bajra**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**ADMINISTRATORI**

Nr. 865/10 prot. Elbasan, me 11.06.2024

**KONTRATE PUBLIKE PËR SHERBIME**
**"Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes"**

E lidhur sot në datë 11.06.2024 në Universitetin e Elbasanit "A.Xhuvani" , mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, bazuar në dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit nr. 162/2020 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 122 Kreu XV, sipas kushteve të mëposhtme:

## KREU I: KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS
### Shërbimet

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë ato të Kushteve të veçanta të kontratës.

**Neni 1: Përkufizime**
- **Autoriteti Kontraktor** është **Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani", përfaqësuar nga Administratori , z. Eljan Hoxha** më poshtë i referuar si **AUTORITETI KONTRAKTOR** (*Autoriteti Kontraktor që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbime*).
- **Kontraktuesi** është Operatori Ekonomik **"UEVI-2015" shpk,** përfaqësuar nga administratori zj. Fatbardha Roka, me adresë Elbasan, Licensë të kategorisë "1.3.A" lëshuar më date 16.03.2016 nga QKL-ja , Nipt- L52904201S, me drejtues teknik z. Fiqiri Elezi, më poshtë referuar si **KONTRAKTUESI** (*personi juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet sherbime*)

**Neni 2: Objekti i kontratës**
Kontraktuesi do të kryejë **"Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes"** për nevoja të Autoritetit Kontraktor, kundrejt pagimit të vlerës së kontratës. Ky shërbim do të jetë në sasi dhe cilësi, sikurse është përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe pranuar në dokumentacionin e ofertës të paraqitur nga Kontraktuesi në tenderin e zhvilluar më date 20.05.2024.

**Neni 3: Vlera Kontratës.**
**Vlera totale e kontratës** (pa TVSH), sipas ofertës së paraqitur në tender nga subjekti fitues **"UEVI-2015"** shpk, është **49,318,155** *(Dyzet e nëntëmilion e treqind e tetëmbëdhjetëmijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë)* **lekë. Vlera e plotë e kontratës** (me TVSH), që do t'i paguhet kontraktuesit **është 59,181,786** *(Pesëdhjetë e nëntëmilion e njëqind e tetëdhjetë e njëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë)* **lekë.** Çmimi i parashikuar më sipër përfshin shërbimin për

ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore, për gjithë periudhën e vlefshmërisë së kontratës dhe përfshin të gjitha shpenzimet e kontraktuesit për shërbimin në fjalë, si dhe të gjitha detyrimet fiskale në fuqi. Autoriteti Kontraktor përgjigjet financiarisht ndaj Kontraktuesit vetëm për ndryshimin zyrtar të detyrimeve fiskale të Kontraktuesit gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

**Neni 4: Kushtet e Pagesës.**

Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:

Pagesa e çmimit të kësaj kontrate do të bëhet nga Autoriteti Kontraktor **çdo muaj**, në monedhën ***lekë*** nëpërmjet bankës **TIRANA BANK**, në llogarinë e subjektit "UEVI-2015" shpk [redacted].

Pagesa do t'i behet Kontraktuesit brenda **30 ditëve** nga data e arritjes së marrëveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor. Kur data e mësipërme është ditë pushimi zyrtar, pagesa do të bëhet ditën pasardhëse të punës. Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

**Neni 5: Fillimi i Kontratës**

Afati i levrimit të shërbimit objekt kontrate, nga Kontraktuesi do të jetë 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës, kjo sipas kërkesave të autoritetit kontrator të përcaktuara në dokumentat e tenderit, të pranuara në ofertën e paraqitur në tender nga operatori ekonomik fitues "UEVI-2015" shpk.

**Neni 6: Vendndodhja e Shërbimeve**

Kontraktuesi do të kryejë shërbimin për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objekteve në ambientet e Universitetit i Elbasanit A. Xhuvani.

| Nr | Adresa e vendndodhjes | Numri i sistem alarmi (elektronik) në objekte | Orari i kryerjes së shërbimit me roje | Nr Turneve | Nr rojeve në objekt |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Korpusi kryesor/Porta hyrese dhe dalese | - | 2 vend/24 orë | I+II+III | 9.96 |
| 2 | Korpusi kryesor (FSHH +FSHN) | - | 1vend/8 orë | I | 1.66 |
| 3 | Rektorati | - | 1vend/8 orë | I | 1.66 |
| 4 | Biblioteka sistem alarmi sipas orareve $16^{00}$-$08^{00}$ (e henë - premte) dhe 24 ore (e shtune, dielë e ditët e festave) | 1 sistem | - | - | - |
| 5 | Shtëpia e pritjes sistem alarmi sipas orareve $16^{00}$-$08^{00}$ (e henë - premte) dhe 24 orë (e shtunë, dielë e ditët e festave) | 1 sistem | - | - | |
| 6 | Magazina e rektoratitit me sistem alarmi sipas orareve $16^{00}$-$08^{00}$ (e henë - premte) dhe 24 orë (e shtunë, dielë e ditët e festave) | 1 sistem | - | - | - |
| 7 | FSHE/Godina e fakultetit të Shkencave të Edukimit | - | 1vend/24 orë | I+II+III | 4.98 |
| 8 | FSHE/Godina e fakultetit të Shkencave të Edukimit | - | 1vend/8 orë | I | 1.66 |

| Nr | Adresa e vendndodhjes | Numri i sistem alarmi (elektronik) në objekte | Orari i kryerjes së shërbimit me roje | Nr Turneve | Nr rojeve në objekt |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | FSHE/Godina e laboratorit të departamentit të edukimit fizik dhe sporteve me sistem alarmi sipas orareve $16^{00}$-$08^{00}$ (e henë - premte) dhe 24 orë (e shtunë, dielë e ditët e festave) | 1 sistem | - | - | - |
| 10 | FSHE/Palestra e departamentit të edukimit fizik dhe sporteve me sistem alarmi sipas orareve $16.^{00}$-$08.^{00}$ (e henë - premte) dhe 24 orë (e shtunë, dielë e ditët e festave) | 1 sistem | - | - | - |
| 11 | Fakulteti Ekonomik | - | 1vend/24 orë | I+II+III | 4.98 |
| 12 | Fakulteti Ekonomik shërbim me roje, turni I dhe sistem alarmi sipas orareve $16^{00}$-$08^{00}$ (e henë - premte) dhe 24 orë (e shtunë, dielë e ditët e festave) | 1 sistem | 1vend/8 orë | I | 1.66 |
| 13 | Fakulteti i Shkencave Mjeksore Teknike | - | 2 vend/24 orë | I+II+III | 9.96 |
| 14 | Laboratori (ish-metalurgjiku) | - | 1vend/24 orë | I+II+III | 4.98 |
| 15 | Godina ish-materniteti | - | 1vend/24 orë | I+II+III | 4.98 |
| 16 | Kampusi Universitar (Krastë) | - | 1 vend/24 orë | I+II+III | 4.98 |
| | Sistem alarmi (elektronik) për objektet e mësipërme 6 (objekte) | 6 sisteme alarmi | - | - | - |
| | Totali roje | | | | 51.46 |

**Neni 7: Sigurimi i kontratës.**

Kontraktuesi për realizimin e detyrimit të tij në këtë kontratë brenda 10 ditësh nga marrja e njoftimit për nënshkrimin e kontratës detyrohet të paraqesë sigurimin e kontratës, në formën e Garancisë Bankare, ose Çertifikatës së Garancisë në Shoqëritë e Sigurimeve, për përmbushjen e detyrimeve të kontratës, në masën **10%** të vlerës totale të kontratës, ose në vlerë absolute jo më pak se **5,918,179 lekë.**

Autoriteti Kontraktor do të bëjë çlirimin e garancisë së kontratës (10 %) brenda 30 ditëve duke filluar nga momenti i përmbushjes së të gjitha detyrimeve të Kontraktuesit.

Shuma e ngurtësuar do të konfiskohet nga Autoriteti Kontraktor, në rast të shkaktimit të dëmit si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi dhe kur ky i fundit nuk pranon të shlyejë dëmin, sipas përcaktimeve në këtë kontratë.

Nuk parashikohet zbritje periodike e garancisë së kontratës

**Neni 8: Detyrimet e Kontraktuesit.**

1. Kontraktuesi Operatori Ekonomik "UEVI-2015" shpk detyrohet të ruajë me armë secilin prej objekteve të përcaktuar në kontratë, sipas përcaktimeve në dokumentet e tenderit për secilën vendndodhje, pa ndërprerje.
2. Kontraktuesi të realizojë shërbimin e sigurimit e ruajtjes me roje civile në përputhje me specifikimet teknike të pasqyruara në dokumentat standart të tenderit, në shtojcën 6, duke zbatuar të gjitha rregullat për regjimin e hyrjes dhe daljes, të ndriçimit, të rrethimit e të mjeteve vëzhguese e sinjalizuese.
3. Kontraktuesi përgjigjet financiarisht për dëmet fizike që mund të pësojnë objektet e përcaktuar për ruajtje, si pasojë e mospërmbushjes së detyrës nga rojet civile me dashje ose nga pakujdesia

(neglizhencë).

3.1 Kontraktuesi nuk përgjigjet financiarisht kur:

- dëmet fizike që pësojnë objektet e përcaktuar për ruajtje, vijne si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore. Për qëllimet e kontratës "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë: lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo etj. të kësaj natyre.
- dëmet fizike që pësojnë objektet e përcaktuar për ruajtje, vijnë si rezultat i dëmtimit të shëndetit të rojes, apo humbja e jetës së tij.
- dëmet fizike që pësojnë objektet e përcaktuar për ruajtje, vijnë si rezultat i mosrespektimit të rregullave të sigurimit teknik nga punonjësit e Kontraktuesit, në objektet përkatëse.

3.2 Për çdo dëm të ndodhur Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor, të hartojë proces-verbalin për rastin konkret, ku të përshkruhet lloji dhe vlefta e dëmit, si dhe të çdëmtojë dëmin kur ai vjen si pasojë e mospërmbushjes së detyrës.

4. Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte periodike mujore, për Autoritetin Kontraktor.
5. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që të ndërpresë kontratën në rast të shpalljes fitues, nga procedura e ndjekur (jo emergjente) dhe nëse shoqëria "Illyrian Guard" sha do të marrë përsipër kryerjen e shërbimit.

**Neni 9: Detyrimet e Autoritetit Kontraktor.**

Autoriteti Kontraktor detyrohet, në zbatim të kësaj kontrate:

1. T'i paguajë Kontraktuesit vlerën e kontratës, sipas përcaktimit të bërë në nenin 3.
2. Të njoftojë me shkrim Kontraktuesin për listën e punonjesve të çdo objekti, të përcaktuar për ruajtje sipas kësaj kontrate, si dhe çdo ndryshim të kësaj liste.
3. Të njoftojë me shkrim Kontraktuesin për regjimin e hyrje-daljeve të punonjësve, për çdo objekt të përcaktuar për ruajtje sipas kësaj kontrate.
4. Të realizojë ndriçimin normal të objekteve të përcaktuar për ruajtje sipas kësaj kontrate, si dhe lidhjen me sistem alarmi nëqoftëse do të shikohet e nevojshme.

**Neni 10: Siguracioni i Përgjegjesisë Profesionale**

Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjesisë profesionale (sigurim për jetën dhe shendetin) për të gjithë punonjësit e Kontraktuesit që ofrojnë shërbimin.

**Neni 11: Ndryshimet dhe prishja e kontratës**

1. Palët mund të bëjnë ndryshime në përmbajtjen e kontratës me pëlqim të të dy palëve me shkrim, kur një gjë e tille nuk ndalohet nga dispozitat ligjore në fuqi.
2. Kur Kontraktuesi tërhiqet nga kontrata ai do të shlyejë të gjitha detyrimet që kanë lindur nga realizimi i pjesëshëm i saj.
3. Në rast se Autoriteti Kontraktor tërhiqet nga kontrata Kontraktuesi mund të kërkojë dëmshpërblim vetem për atë pjesë të realizuar të kontratës.

**Neni 12: Dispozita të fundit**

Kontrata hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët.

Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt për zgjidhjen e tyre palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES
## Shërbimet - Procedura e Hapur

**Neni 1 Qëllimi**

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruara me anë të procedurës së hapur.

1.2 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruara me anë të procedurës së hapur.

1.3 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.4 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.5 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

1.6 Kushtet e kontratës, përfshijnë, gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2 Përkufizime**

2.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.2 "Çmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.3 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.4 "Palë (t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.5 "Autoriteti Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbimin. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.6 "Kontraktues" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

2.7 "Shërbime ne lidhje me to" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

2.8 "Termat e References" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojne detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**Neni 3 Hartimi i Kontratës**

3.1 Shpallja e fituesit do të sherbejë per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 5 Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6 Prona Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuara ne përgjithsi.

7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashte kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha sherbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.

9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

**Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.

11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.

11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

**Neni 12 Vendndodhja**

12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.

12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet ne mënyrë të paarsyeshme.

**Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

**Neni 14 Çmimi i Kontratës**

14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 15 Afatet e Pagesës**

15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhen në kohë siç specifikohet në kontratë.

15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita qe janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

15.5 Data e pagesës do të jëte dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve**

17.1 Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke

përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 18 Forca Madhore**

18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

18.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.

19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Autoriteti kontraktor ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

**Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar**

20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

**Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet**

21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 22 Ndryshimi i Porosisë**

22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

**Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim**

23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

**Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

**Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

UEVI-2015



ELBASAN

**Neni 26 Nënkontrata**

26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësine e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

26.3 Cdo nenkontraktor duhet të kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizoje një pjesë të punimeve me nënkontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje.

26.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 27 Transferimi i të Drejtave**

31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

**Neni 28 Sigurimi i Kontrates**

28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar

28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

**Neni 29 Baza Ligjore**

29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 31 Përfaqesimi i Palëve**

31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

**Neni 32 Lajmërimet**

32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 33 Llogaritja e Afateve**

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe

**Kjo kontratë u përpilua ne katër kopje duke u ndarë në tre kopje për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin.**
**Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të dyja palët, të cilët e firmosen dhe e vulosen atë respektivisht në çdo faqe.**

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**
**ADMINISTRATORI**
**Eljan Hoxha**

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"UEVI-2015" shpk**
**ADMINISTRATOR**
**Fatbardha Roka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
ADMINISTRATORI

## ANEKS KONTRATE

**Objekti: "Shërbime të Sigurimit dhe Ruajtjes" për 12 muaj**

| Nr | Përshkrimi i Shërbimeve | Njësia (Muaj) | Sasia (nr vendrojeve) | Çmimi lekë /muaj | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me roje fizike me tre turne 24 ore me koefiçent **4.98** | 12 | 9 | 404,990.38 | 43,738,961 |
| 2 | Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me roje fizike me nje turne i pare 8 ore me koefiçent **1.66** | 12 | 4 | 116,233.20 | 5,579,194 |
| 3 | Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me sistem elektronik objekteve | 12 | 6 | 0.00 | 0 |
| | **Shuma (pa TVSH)** | | | | 49,318,155 |
| | **TVSH 20%** | | | | 9,863,631 |
| | **Shuma (me TVSH)** | | | | 59,181,786 |

Kjo kontratë u përpilua ne katër kopje duke u ndarë në tre kopje për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin.
Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të dyja palët, të cilët e firmosen dhe e vulosen atë respektivisht në çdo faqe.

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**

**ADMINISTRATORI**
**Eljan Hoxha**

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"UEVI-2015" shpk**

**ADMINISTRATOR**
**Fatbardha Roka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
ADMINISTRATORI

Nr. 859/34 prot. Elbasan, me 08.08.2024

## KONTRATE PUBLIKE PËR SHËRBIME

**"Blerje kancelari, tonera, drum e furra per fotokopje e printera"**

E lidhur sot në datë 08.08.2024 në Universitetin "A.Xhuvani" Elbasan, mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, bazuar në dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit nr. 162 dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Rregullat e Prokurimit Publik", sipas kushteve të mëposhtme:

### KREU I: KUSHTET E VEÇANTA (Mallra)

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

**Neni 1: Përkufizime**

- Autoriteti Kontraktor është – **Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**, përfaqësuar nga **Admistratori z. Eljan Hoxha,** njohur më poshtë si **"AUTORITETI KONTRAKTOR"** *(Blerësi Publik).*
- Kontraktuesi është Operatori Ekonomik "**XPERT SYSTEMS" shpk**, i përcaktuar më poshtë si "**KONTRAKTUESI**" (sipërmarrësi), me seli në Tiranë, Rruga "Mihal Duri"i regjistruar më dt. 11.03.2015, me NIPT me nr. L51511023L, përfaqësuar nga **Administrator , z. Renald Gova,** i cili përfaqëson këtë subjekt për detyrimet e kësaj kontrate, më poshtë i referuar si **KONTRAKTUESI** (*personi juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet sherbime*).

**Neni 2: Objekti i kontratës dhe sasia e mallit**

Mbi bazën e dokumentacionit që disponon pas fitimit të prokurimit publik të zhvilluar në datë 23.05.2024, do të kryej furnizimin për objektin: "Blerje kancelari, tonera, drum e furra per fotokopje e printera" sipas aneksit të kontratës.

**Neni 3: Specifikimet teknike të mallit**

Cilësia dhe specifikimet teknike të mallit objekt kontrate do të jenë ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit (shtojca 5) dhe të pranuara nga Kontraktuesi në dokumentat e ofertës te të paraqitura nga ky operator ekonomik në tenderin e zhvilluar nga autoriteti kontraktor në datë 23.05.2024.

**Neni 4: Çmimi i Kontratës.**
**Vlera totale kontratës** *(pa tvsh)* është **3,222,200** *(Tremilion e dyqind e njëzet e dymijë e dyqind)* lekë. **Vlera e plotë e kontratës** *(me tvsh)* që do ti paguhet kontraktuesit është **3,866,640** *(Tremilion e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e dyzet)* lekë.

**Neni 5: Sigurimi i Kontratës**
Garancia e kontratës e paraqitur nga Kontraktuesi para lidhjes së kontratës, sipas modelit përkatës dhënë në dokumentat e tenderit ka vlerën 10 % të vlerës së kontratës në shumën absolute **386,664** lekë. Kjo shumë do të garantojë autoritetin kontraktor për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi (shitësi).
Çlirimi i garancisë së kontratës do të bëhet me shkrim nga Blerësi Publik, 30 ditë pas përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi.

**Neni 6: Fillimi i zbatimit dhe mënyra e levrimit**
Lëvrimi i mallit do të kryhet brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës sipas aneksit të kontratë bashkëngjitur.

**Neni 7: Inspektimet dhe Testimet, për cilësinë e mallit.**
Kontraktuesi garanton që malli do të plotësojë të gjitha kërkesat për cilësinë dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit .
Në çdo moment që autoriteti kontraktor konstaton se malli i lëvruar nuk ka cilësinë dhe specifikimet teknike të kërkuara, ai i kërkon kontraktuesit dhe ky i fundit është i detyruar të furnizoj pa pagesë një sasi tjetër të barabartë me sasinë e furnizuar më parë, e cila plotëson kërkesat për cilësi dhe specifikimet teknike të kërkuara.

**Neni 8: Kushtet e Dorëzimit**
Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit. Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë gjithë ditëve pune të javës dhe në çdo kohë në magazinën e Autoritetit Kontraktor.

**Neni 9: Kushtet e Pagesës**
Pagesa do të kryhet kundrejt paraqitjes së dokumentacionit justifikues (faturës) të rregullt, të pranuar nga autoriteti kontraktor, **brenda 1 (një) muaji** nga dita e paraqitjes së dokumentit. Monedha me të cilën do të bëhet pagesa është **Lek.**
Numri i llogarisë bankare të Kontraktuesit është në **Raiffeisen Bank** me **IBAN:** [redacted] Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

**Neni 10: Zgjidhja e kontratës**
Kontrata mund të zgjidhet duke pushuar çdo efekt të saj me njoftimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktor në rastet e mëposhtme :

1. Në rastin e mosfurnizimit të sasisë së plotë të mallrave sipas kërkesës së autoritetit kontraktor pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.
2. Në rast mosplotësimi të kërkesave të cilësisë së mallit objekt kontrate dhe mospranimit nga Kontraktuesi për zëvëndësimin e kësaj sasie me një sasi tjetër të barabartë me të parën, që i përmbush këto kërkesa pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e mësipërm kontrata do të zgjidhet duke respektuar dispozitat e Kodit Civil.

**Neni 11: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**
Për çdo marreveshje që mund të lind në zbatimin e kontratës, nëse ato nuk zgjidhen në marrëveshje midis palëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK)**
**Procedur e Hapur e Thjeshtuar**

**Neni 1: Dispozitat e përgjithshme**

**1.1 Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

**1.1.1 Kontrata**

1.1.1.1 "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

1.1.1.2 "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

1.1.1.3 "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

1.1.1.4 "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

1.1.1.5 "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 25.

1.1.1.6 "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Mallrave objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

1.1.1.7 "Vizatimet" do të thotë vizatimet e Mallrave, siç janë përfshirë në Kontratë, dhe çdo vizatim shtesë dhe i modifikuar i lëshuar nga (ose në emër dhe për llogari të) Blerësit në përputhje me Kontratën.

1.1.1.8 "Katalog" do të thotë një "libër" që përmban listën e produkteve/mallrave përfshirë përshkrimet e cilësive/specifikimeve, si dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

1.1.1.9 "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

1.1.1.10 "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

1.1.1.11 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.1.1.12 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**1.1.2 Palët e Kontratës**

1.1.2.1 "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

1.1.2.2 "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Mallrave objekt kontrate.

1.1.2.3 "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që furnizon Mallrat objekt kontrate.

1.1.2.4 "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për ofrimin e një pjese të Mallrave ose Shërbimeve të Lidhura me to.

**1.1.3 Datat, Testet, Periudhat dhe Përfundimi**

1.1.3.1 "Test i Pranimit" do të thotë testet (nëse janë të aplikueshme) të cilat janë specifikuar në Kontratë dhe që kryhen në përputhje me Specifikimet për qëllimin e pranimit të Mallrave.

1.1.3.2 "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

**1.1.4 Mallrat**

1.1.4.1 "Mallra" do të thotë të gjitha mallrat, lënda e parë, makineritë dhe pajisjet dhe / ose materialet e tjera që Furnizuesit duhet t'i furnizojnë Blerësit sipas Kontratës.

1.1.4.2 "Shërbime të Lidhura" do të thotë shërbimet e rastit të lidhura me furnizimin e Mallrave, siç janë sigurimi, transporti, instalimi, vënia në punë, trajnimi dhe mirëmbajtja fillestare ose ndonjë shërbim tjetër i kësaj natyre sipas Kontratës.

**1.1.5 Përkufizime të tjera**

1.1.5.1 "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

1.1.5.2 "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 22 "Forca Madhore".

1.1.5.3 "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 10 "Sigurimi i Kontratës".

1.1.5.4 "Vendi i dorëzimit të Mallrave", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

1.1.5.5 "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

1.1.5.6 Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 23.

1.1.5.7 "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK

1.1.5.8 "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

**1.2 Interpretimi**

**1.2.1 Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:**

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;
(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

**1.2.2 Inkotermat**

(a) "Inkotermat" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
(b) Përveçse kur nuk është në përputhje me ndonjë dispozitë të Kontratës, kuptimi i çdo termi tregtar dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve në të do të jenë siç përshkruhet nga Inkotermat.
(c) Inkotermat, kur përdoren, rregullohen nga rregullat e përshkruara në botimin aktual të Inkotermave, të specifikuara në KVK, dhe të publikuara nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

**1.2.3 Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

**1.2.4 Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

**1.2.5 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

**1.3 Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

 (i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

 (ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa. Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

**1.4 Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë. Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

**1.5 Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

**1.6 Hartimi i Kontratës**

1.6.1 Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

1.6.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

**E drejta e autorit**

1.6.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha vizatimet, dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe

informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

**1.7 Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Mallrave të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

**1.8 Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës 1.9 (a) këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cenuar Nenin 7.1.

**1.9 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

**1.10 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.
Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2: Praktikat e Ndaluara**

**2.1.** Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

**2.2.** Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.
Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3: Njoftimet**

**3.1** Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

**3.2** Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4: Objekti i Furnizimit**

**4.1** Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të furnizohen duhet të jenë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**4.2** Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5: Dorëzimi**

**5.1** Dorëzimi i Mallrave dhe Përfundimi i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 6: Përgjegjësitë e Furnizuesit**

**6.1** Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në Objektin e Furnizimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 7: Çmimi i Kontratës**

**7.1** Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 21.

**Neni 8: Kushtet e Pagesës**

**8.1** Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK. Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Mallrat e dorëzuara dhe Shërbimet e Lidhura me to të kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

**8.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Bleresi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Bleresi ta ketë pranuar atë.

**8.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

**8.4** Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 9: Tatimet, Taksat dhe Detyrimet e tjera**

**9.1** Për Mallrat e prodhuara jashtë vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, taksat e pullës, tarifat e licencës dhe detyrime të tjera të tilla të vendosura jashtë vendit të Blerësit.

**9.2** Për Mallrat e prodhuara brenda vendit të Blerësit, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, detyrimet, tarifat e licencës, etj., të lindura deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara tek Blerësi.

**9.3** Nëse në vendin e Blerësit, mund të jetë i disponueshëm për Furnizuesin ndonjë përjashtim, ulje, lejim ose favor tatimor, Blerësi duhet t'i krijojë mundësi Furnizuesit të përfitojë nga këto lehtësira.

**Neni 10: Sigurimi i Kontratës**

**10.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.

**10.2** Në përputhje me Nenin 10.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.

**10.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.

**10.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 11: Nënkontraktimi**

**11.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.

**11.2** Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit.

**11.3** Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 12: Specifikimet dhe Standardet**

**12.1** Furnizuesi duhet të sigurojë që Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura të jenë në përputhje me Kërkesat Teknike, siç specifikohet në Dokumentet e Tenderit.

Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Blerësi, me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Furnizuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Blerësin për të.
Kudo që bëhen referenca në Kontratë për kodet dhe standardet, në përputhje me të cilat do të ekzekutohet, shtesa ose versioni i rishikuar i kodeve dhe standardeve të tilla, do të jenë ato të specifikuara në kërkesat e dokumenteve të tenderit. Çdo ndryshim në cilindo kod dhe standard, gjatë ekzekutimit të Kontratës, do të zbatohet vetëm pas miratimit nga Blerësi dhe do të trajtohet në përputhje me Nenin 23 të këtyre kushteve dhe dispozitat e LPP-së për modifikimin e Kontratës, Neni 127.

**Neni 13: Paketimi dhe Dokumentet**

**13.1** Furnizuesi siguron paketimin e mallrave siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin ose përkeqësimin e tyre gjatë transportit në destinacionin e tyre përfundimtar, siç përshkruhet në Kontratë. Gjatë transportit, paketimi duhet të jetë i tillë që t'i rezistojë ekspozimit ndaj temperaturave ekstreme, kripës dhe reshjeve dhe kushteve të magazinimit. Madhësia dhe peshat e kutisë së paketimit do të marrin parasysh, kur është e përshtatshme, largësinë e destinacionit përfundimtar të Mallrave.

**13.2** Paketimi, shënjimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në përputhje me kërkesat e veçanta siç parashikohen shprehimisht në Kontratë, përfshirë kërkesat shtesë, nëse ka, të specifikuara në KVK, dhe në çdo kërkesë tjetër nga Blerësi.

**Neni 14: Siguracioni**

**14.1** Përveç nëse specifikohet ndryshe në KVK, Furnizuesi duhet të sigurojë që Mallrat që do të dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit të lidhur me prodhimin ose blerjen, transportin, magazinimin dhe dorëzimin, në përputhje me Inkotermat e zbatueshme ose në mënyrën e specifikuar në KVK.

**Neni 15: Transporti**

**15.1** Përveçse kur përcaktohet ndryshe në KVK, përgjegjësia për organizimin e transportit të Mallrave do të jetë në përputhje me Inkotermat e zbatueshme.

**Neni 16: Inspektimet dhe testet**

**16.1** Furnizuesi do të kryejë me shpenzimet e veta dhe pa asnjë kosto për Blerësin, të gjitha testet dhe / ose inspektimet e tilla të Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to siç specifikohet në KVK.

**16.2** Inspektimet dhe testet mund të kryhen në ambientet e Furnizuesit ose Nënkontraktorit të tij, në pikën e dorëzimit, dhe / ose në destinacionin përfundimtar të Mallrave, ose në një vend tjetër në vendin e Blerësit siç përcaktohet në KVK. Nëse kryhen në ambientet e Furnizuesit ose Nënkontraktorit të tij, të gjitha lehtësitë dhe ndihma e arsyeshme, duke përfshirë aksesin tek vizatimet dhe të dhënat e prodhimit, do t'u dorëzohen inspektorëve pa pagesë për Blerësin.

**16.3** Përfaqësuesit e caktuar të Blerësit kanë të drejtë të marrin pjesë në testet dhe / ose inspektimet e përmendura në Nenin 16.2, me kusht që Blerësi të përballojë të gjitha kostot dhe shpenzimet e tij të kryera në lidhje me një pjesëmarrje të tillë duke përfshirë, por pa u kufizuar, të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit.

**16.4** Kurdoherë që Furnizuesi është i gatshëm të kryejë ndonjë test dhe inspektim të tillë, ai do t'i bëjë një njoftim të arsyeshëm paraprak, Blerësit, duke përfshirë vendin dhe kohën. Furnizuesi do të marrë nga çdo Palë e tretë përkatëse ose prodhues çdo leje ose pëlqim të nevojshëm për t'i mundësuar Blerësit ose përfaqësuesit të tij të caktuar të marrë pjesë në test dhe / ose inspektim.

**16.5** Blerësi mund të kërkojë nga Furnizuesi të kryejë çdo test dhe / ose inspektim që nuk kërkohet nga Kontrata, por konsiderohet i nevojshëm për të verifikuar nëse karakteristikat dhe performanca e Mallrave përputhen me kodet dhe standardet e Specifikimeve Teknike sipas Kontratës. Blerësi do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Nëse një test dhe / ose inspektim i tillë pengon progresin e prodhimit dhe / ose kryerjen nga ana e Furnizuesit të detyrimeve të tjera të tij sipas Kontratës, Blerësi do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.

**16.6** Furnizuesi do t'i sigurojë Blerësit një raport të rezultateve të çdo testi dhe / ose inspektimi të tillë.

**16.7** Blerësi mund të refuzojë çdo Mall ose ndonjë pjesë të tij që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është në përputhje me Specifikimet. Furnizuesi do të ndreqë ose zëvendësojë Mallrat e refuzuar apo pjesë të tyre ose do të bëjë ndryshimet e nevojshme për të përmbushur specifikimet pa ndonjë kosto për Blerësin, dhe do të përsërisë testin dhe / ose inspektimin, pa asnjë kosto për Blerësin, pasi të njoftojë në përputhje me Nenin 16.4.

**16.8** Furnizuesi bie dakord që ekzekutimi i një testi dhe / ose inspektimi i Mallrave ose ndonjë pjese të tyre, nuk e shkarkojnë Furnizuesin nga garancitë ose detyrimet e tjera sipas Kontratës.

**Neni 17: Dëmet e likujduara**

17.1 Dëmet e likujduara për dorëzimin e vonuar të mallrave do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 18: Garancia**

**18.1** Furnizuesi garanton që Mallrat nuk kanë defekte që vijnë nga ndonjë veprim ose mosveprim i Furnizuesit ose që vijnë nga skicimi, materialet dhe punimi nën përdorimin normal në kushtet që mbizotërojnë në vendin e destinacionit përfundimtar.

**18.2** Blerësi përcakton në KVK kohëzgjatjen e vlefshmërisë së garancisë (nëse është rasti), pasi Mallrat, ose ndonjë pjesë e tyre sipas rastit, të jenë dorëzuar dhe pranuar në destinacionin përfundimtar të përshkruar në KVK.

**18.3** Blerësi do të njoftojë Furnizuesin duke treguar natyrën e defekteve të tilla së bashku me të gjitha provat e disponueshme të tyre, menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se

dhjetë ditë nga zbulimi. Blerësi do të sigurojë të gjitha mundësitë që Furnizuesi të inspektojë defekte të tilla.

**18.4** Pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi duhet, brenda periudhës së specifikuar në KVK, të riparojë ose zëvendësojë me shpejtësi Mallrat ose pjesët e dëmtuara, pa ndonjë kosto për Blerësin.

Nëse pas marrjes së njoftimit, Furnizuesi nuk arrin të rregullojë defektin brenda periudhës së specifikuar më sipër, Blerësi mund të kryejë rregullimet e nevojshme me shpenzimet e Furnizimit. Në çdo rast, Blerësi mund të vendosë që të njoftojë Furnizuesin për ndërprerjen e Kontratës.

### Neni 19: Zhdëmtimi i Patentës

**19.1** Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) instalimit të mallrave nga Furnizuesi ose përdorimit të mallrave në vendin e dorëzimit të Mallrave;

dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Mallrat. Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Mallrat ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

**19.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 19.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

**19.3** Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

### Neni 20: Kufizimi i Përgjegjësisë

**20.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve

ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara;

dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e riparimit ose zëvendësimit të pajisjeve me defekt, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 21: Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

**21.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 22: Forca madhore**

**22.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

**22.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

**22.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

**Neni 23: Modifikimi i Kontratës**

**23.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

**23.2** Blerësi mund t'i paraqesë kërkesë në çdo kohë Furnizuesit, të bëjë modifikime brenda objektit të përgjithshëm të Kontratës në një ose më shumë nga kushtet si vijon:

(a) vizatimet, skicat ose specifikimet, ku Mallrat që do të furnizohen sipas Kontratës duhet të prodhohen posaçërisht për Blerësin;

(b) mënyra e dërgesës ose paketimit;

(c) vendin e dorëzimit; dhe

(d) Shërbimet e Lidhura që do të ofrohen nga Furnizuesi.

**23.3** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për

përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

**23.4** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 24: Zgjatja e afatit**

**24.1** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë dërgimin në kohë të Mallrave ose përfundimin e Shërbimeve të Lidhura në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

**24.2** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 22, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

**Neni 25: Ndërprerja e Kontratës**

**25.1 Njoftim për të korrigjuar**

Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

**25.2 Ndërprerja për mospërmbushje**

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

(i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 25.1 të këtij neni;

(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të dorëzojë ndonjë ose të gjitha Mallrat brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 24;

ose

(iii)Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

**25.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

**25.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

(a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

(b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.
(c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Mallrat e pranuara dhe Shërbimet e lidhura me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve të lidhura me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 26: Kufizimet e Eksportit**

**26.1** Pavarësisht nga çdo detyrim sipas Kontratës për të përfunduar të gjitha formalitetet e eksportit, çdo kufizim eksporti që i atribuohet Blerësit, vendit të Blerësit ose përdorimit të mallrave ose shërbimeve që do të furnizohen, të cilat rrjedhin nga rregulloret tregtare nga një vend që furnizon ato mallra ose shërbime, dhe të cilat në mënyrë të konsiderueshme e pengojnë Furnizuesin për të përmbushur detyrimet e tij sipas Kontratës, do ta shkarkojnë Furnizuesin nga detyrimi për të ofruar dërgesa ose shërbime, gjithnjë me kusht që Furnizuesi të demonstrojë në mënyrë të kënaqshme për Blerësin që i ka përfunduar të gjitha formalitetet në kohën e duhur, duke përfshirë aplikimet për leje, autorizime dhe licenca të nevojshme për dërgimin e mallrave ose shërbimeve sipas kushteve të Kontratës.

**Neni 27: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**27.1** Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

**27.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

**Kjo kontratë u përpilua në katër kopje duke u ndarë në tre kopje për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin. Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të të dyja palët, të cilët e firmosën dhe e vulosën atë respektivisht në çdo faqe.**

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**
**ADMINISTRATORI**
**Eljan Hoxha**

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"XPERT SYSTEMS"**
**ADMINISTRATORI**
**Renald Gova**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**ADMINISTRATORI**

Nr._______ prot. Elbasan, me 08.08.2024

## KONTRATE PUBLIKE PËR SHËRBIME

### "Blerje kancelari, tonera, dram e furra për fotokopje e printera"

| Nr | Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi pa Tvsh | Vlera pa TVSH | TVSH | Vlera me tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Drum - Fotokopje Color MFP Advanced - XEROX Atalink C8145 | copë | 3 | 36,000 | 108,000 | 21,600 | 129,600 |
| 2 | Drum - Fotokopje Kyocera fs-1030 | copë | 2 | 12,000 | 24,000 | 4,800 | 28,800 |
| 3 | Drum - Fotokopje KYOCERA fs-1130 mfp/dp - (DV-1130E) | copë | 2 | 12,000 | 24,000 | 4,800 | 28,800 |
| 4 | Drum - Fotokopje KYOCERA fs-1320D | copë | 2 | 12,000 | 24,000 | 4,800 | 28,800 |
| 5 | Drum - Fotokopje Xerox Workcenter C128-6R1182 | copë | 2 | 14,000 | 28,000 | 5,600 | 33,600 |
| 6 | Drum - Fotokopje xerox workcentre 5020 | copë | 2 | 24,000 | 48,000 | 9,600 | 57,600 |
| 7 | Drum Fotokopje Sharp AR 5631 | copë | 3 | 10,500 | 31,500 | 6,300 | 37,800 |
| 8 | Drum- Fotokopje Xerox Workcentre 5330 | copë | 5 | 28,000 | 140,000 | 28,000 | 168,000 |
| 9 | T/Cart - Printer HP laserjet 1020 - Q2612A | copë | 2 | 3,500 | 7,000 | 1,400 | 8,400 |
| 10 | T/Cart - Printer HP M501dn - CF287A | copë | 12 | 7,600 | 91,200 | 18,240 | 109,440 |
| 11 | T/Cart - Printer Kyocera 2040 | copë | 1 | 7,600 | 7,600 | 1,520 | 9,120 |
| 12 | T/Cart - Printer Kyocera P2040DN | copë | 1 | 8,500 | 8,500 | 1,700 | 10,200 |
| 13 | T/Cart - Printer Kyocera P3145 dn B&W | copë | 1 | 7,400 | 7,400 | 1,480 | 8,880 |
| 14 | T/cart - Printer laser Color (all in one) Canon i-Sensys MF633Cdw - Canon 045H High -Yild Black | copë | 1 | 7,500 | 7,500 | 1,500 | 9,000 |
| 15 | T/cart - Printer laser Color (all in one) Canon i-Sensys MF633Cdw - Canon 045H High -Yild Cyan | copë | 1 | 7,500 | 7,500 | 1,500 | 9,000 |
| 16 | T/cart - Printer laser Color (all in one) Canon i-Sensys MF633Cdw - Canon 045H High -Yild Magenta | copë | 1 | 7,500 | 7,500 | 1,500 | 9,000 |
| 17 | T/cart - Printer laser Color (all in one) Canon i-Sensys MF633Cdw - Canon 045H High -Yild Yellow | copë | 1 | 7,500 | 7,500 | 1,500 | 9,000 |
| 18 | T/Cart - Printer LEXMARK MS312DN | copë | 10 | 6,500 | 65,000 | 13,000 | 78,000 |
| 19 | T/Cart - Printer LEXMARK Ms-317DN | copë | 15 | 6,500 | 97,500 | 19,500 | 117,000 |
| 20 | T/Cart - Printer LEXMARK B2650 dw | copë | 15 | 7,000 | 105,000 | 21,000 | 126,000 |
| 21 | T/Cart - Printer Lexmark Cx-317dn - CS/CX 317 Black color | copë | 1 | 10,000 | 10,000 | 2,000 | 12,000 |

| Nr | Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi pa Tvsh | Vlera pa TVSH | TVSH | Vlera me tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | T/Cart - Printer Lexmark Cx-317dn - CS/CX 317 Cyan color | copë | 1 | 10,000 | 10,000 | 2,000 | 12,000 |
| 23 | T/Cart - Printer Lexmark Cx-317dn - CS/CX 317 Magenta color | copë | 1 | 10,000 | 10,000 | 2,000 | 12,000 |
| 24 | T/Cart - Printer Lexmark Cx-317dn - CS/CX 317 Yellow color | copë | 1 | 10,000 | 10,000 | 2,000 | 12,000 |
| 25 | T/Cart - Printer Samsung ML-1665 - MLT-D1042 | copë | 1 | 8,500 | 8,500 | 1,700 | 10,200 |
| 26 | T/Cart - Printer Samsung ML-1865 - MLT-D1042S | copë | 4 | 6,000 | 24,000 | 4,800 | 28,800 |
| 27 | T/Cart - Printer Samsung ML-2165 | copë | 1 | 6,000 | 6,000 | 1,200 | 7,200 |
| 28 | T/Cart Black - Fotokopje Color MFP Advanced - XEROX Atalink C8145 | copë | 10 | 20,000 | 200,000 | 40,000 | 240,000 |
| 29 | T/Cart Cyan - Fotokopje Color MFP Advanced - XEROX Atalink C8145 | copë | 10 | 20,000 | 200,000 | 40,000 | 240,000 |
| 30 | T/Cart Magenta - Fotokopje Color MFP Advanced - XEROX Atalink C8145 | copë | 10 | 20,000 | 200,000 | 40,000 | 240,000 |
| 31 | T/Cart Yellow - Fotokopje Color MFP Advanced - XEROX Atalink C8145 | copë | 10 | 20,000 | 200,000 | 40,000 | 240,000 |
| 32 | Toner - Fotokopje Canon IR 1024 | copë | 3 | 6,000 | 18,000 | 3,600 | 21,600 |
| 33 | Toner - Fotokopje CANON iR 2530i -A3 | copë | 1 | 5,000 | 5,000 | 1,000 | 6,000 |
| 34 | Toner - Fotokopje Koycera TASK alfa 3212i Black (TK- 7127) ose (TK- 7125) | copë | 20 | 8,000 | 160,000 | 32,000 | 192,000 |
| 35 | Toner - Fotokopje Kyocera ECOSYS M4125i dn B&W | copë | 1 | 8,000 | 8,000 | 1,600 | 9,600 |
| 36 | Toner - Fotokopje Kyocera fs-1030 | copë | 1 | 8,000 | 8,000 | 1,600 | 9,600 |
| 37 | Toner - Fotokopje KYOCERA fs-1130 mfp/dp - (DV-1130E) | copë | 4 | 10,000 | 40,000 | 8,000 | 48,000 |
| 38 | Toner - Fotokopje Kyocera TASK alfa 2553ci Color MFP Basic - T/Cart Black | copë | 10 | 10,000 | 100,000 | 20,000 | 120,000 |
| 39 | Toner - Fotokopje Kyocera TASK alfa 2553ci Color MFP Basic - T/Cart Cyan | copë | 10 | 10,000 | 100,000 | 20,000 | 120,000 |
| 40 | Toner - Fotokopje Kyocera TASK alfa 2553ci Color MFP Basic - T/Cart Magenta | copë | 10 | 10,000 | 100,000 | 20,000 | 120,000 |
| 41 | Toner - Fotokopje Kyocera TASK alfa 2553ci Color MFP Basic - T/Cart yellow | copë | 10 | 10,000 | 100,000 | 20,000 | 120,000 |
| 42 | Toner - Fotokopje Kyocera TASKalfa 5053ci Color MFP advanced -TK-8515C Cyan | copë | 3 | 22,000 | 66,000 | 13,200 | 79,200 |
| 43 | Toner - Fotokopje Kyocera TASKalfa 5053ci Color MFP advanced -TK-8515K Black | copë | 3 | 22,000 | 66,000 | 13,200 | 79,200 |
| 44 | Toner - Fotokopje Kyocera TASKalfa 5053ci Color MFP advanced -TK-8515M Magenta | copë | 3 | 22,000 | 66,000 | 13,200 | 79,200 |
| 45 | Toner - Fotokopje Kyocera TASKalfa 5053ci Color MFP advanced -TK-8515Y Yellow | copë | 3 | 22,000 | 66,000 | 13,200 | 79,200 |
| 46 | Toner - Fotokopje Sharp AR -6020 M - DVNT 1254US25-2-B | copë | 3 | 5,000 | 15,000 | 3,000 | 18,000 |

| Nr | Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi pa Tvsh | Vlera pa TVSH | TVSH | Vlera me tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 47 | Toner - Fotokopje Sharp MX-M316N - T/Cart MX-M316N Black | copë | 5 | 7,500 | 37,500 | 7,500 | 45,000 |
| 48 | Toner - Fotokopje XEROX B1022 | copë | 3 | 8,500 | 25,500 | 5,100 | 30,600 |
| 49 | Toner - Fotokopje XEROX B7030-B7W MFP | copë | 10 | 11,000 | 110,000 | 22,000 | 132,000 |
| 50 | Toner - Fotokopje Xerox Workcentre 5330 - T/cart 006R01160 | copë | 7 | 15,000 | 105,000 | 21,000 | 126,000 |
| 51 | Toner - Printer EPSON LQ-690 Traktor - Ribban | copë | 30 | 7,900 | 237,000 | 47,400 | 284,400 |
| 52 | Toner Fotokopje Xerox Workcenter C128-6R1182 | copë | 4 | 5,000 | 20,000 | 4,000 | 24,000 |
| 53 | Fshirëse - Fotokopje Sharp AR 5631 | copë | 3 | 8,000 | 24,000 | 4,800 | 28,800 |
| 54 | Toner - Fotokopje xerox workcentre 5020 | copë | 5 | 4,000 | 20,000 | 4,000 | 24,000 |
| | **Shuma** | | | | **3,222,200** | **644,440** | **3,866,640** |

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**
**ADMINISTRATORI**
**Eljan Hoxha**

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"XPERT SYSTEMS"**
**ADMINISTRATORI**
**Renald Gova**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**REKTORATI**

Nr. 891/7 prot. Elbasan, më 26.04.2024

**KONTRATE PUBLIKE PËR SHËRBIME**
**"Ekspedita mësimore dhe praktika në terren"**

E lidhur sot në datë 26.04.2024 në zyrat e Universitetit i Elabasanit "A.Xhuvani" , mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM-ja nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullat e Prokurimit Publik" e ndryshuar:

**KREU I: KUSHTET E VEÇANTA (Shërbime)**

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë ato të Kushteve të veçanta të kontratës.

**Neni 1: Përkufizime**

- **Autoriteti Kontraktor** është **Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan**, përfaqësuar nga **Administratori, z. Eljan Hoxha** më poshtë i referuar si **AUTORITETI KONTRAKTOR** *(Autoriteti Kontraktor që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbime).*
- **Kontraktuesi** është **Operatori Ekonomik "LLIXHA 2001" shpk**, i përcaktuar më poshtë si **"KONTRAKTUESI" (sipërmarrësi)**, me seli në Elbasan, i regjistruar më dt. 16.03.2021, me **NIPT me nr. K13127201O**, me **administrator (drejtues ligjor) z. Ardjan Daka**, i cili përfaqëson këtë subjekt për detyrimet e kësaj kontrate, më poshtë i referuar si **KONTRAKTUESI** *(personi juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet sherbime).*

**Neni 2: Objekti i kontratës**

Mbi bazën e dokumentacionit që disponon pas fitimit të prokurimit publik të zhvilluar në datë 22.04.2024, autoriteti kontraktor i beson subjektit kontraktuesit realizimin e kontratës publike të shërbimit me objekt: "Ekspedita mesimore dhe praktika ne terren", kundrejt pagesës së çmimit të kontratës. Sasitë e shërbimeve që do të blihen janë sipas listës bashkëlidhur.

**Neni 3: Specifikimet teknike.**

Cilësia dhe specifikimet teknike të shërbimve objekt kontrate do të jenë ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit (shtojca 4) dhe të pranuara nga Kontraktuesi në dokumentat e ofertës të paraqitura nga ky operator ekonomik në tenderin e zhvilluar nga autoriteti kontraktor në datë 22.04.2024.

**Neni 4: Çmimi i Kontratës.**

Çmimet i sherbimve do të jenë fiks (të pa ndryshueshëm) deri në përfundim të kontratës, çmime që përcaktohen në dokumentacionin e ofertës të paraqitur nga kontraktuesi në tender.
**Vlefta totale e kësaj Kontrate**, është e shprehur në lekë, për **vlerën** (pa tvsh) **1,216,446** *(Njëmilion e dyqind e gjashtëmbedhjetëmijë e katërqind e dyzetë e gjashtë)* lek. **Vlera totale** (me

Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al

TVSH) që do t'i likuidohet kontraktuesit është **1,459,735** *(Njëmilion e katërqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë)* lek.

**Neni 5: Fillimi i zbatimit dhe mënyra e levrimit**
Levrimi i sherbimit do të kryhet rast pas rasti sipas nevojave të AK 12 muaj nënshkrimit të kontratës.

**Neni 6: Sigurimi i Kontratës**
Garancia e kontratës e paraqitur nga Kontraktuesi para lidhjes së kontratës, sipas modelit përkatës dhënë në dokumentat e tenderit ka vlerën 10% të vlerës së kontratës në shumën absolute 145,973.5 lekë. Kjo shumë do të garantojë autoritetin kontraktor për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi (shitësi). Çlirimi i garancisë së kontratës do të bëhet me shkrim nga Blerësi Publik, 30 ditë pas përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi.

**Neni 7: Kushtet e Pagesës.**
Pagesa do të kryhet kundrejt paraqitjes së dokumentacionit justifikues (faturës) të rregullt, të pranuar nga autoriteti kontraktor, brenda 1 (një) muaji nga dita e paraqitjes së dokumentit. Monedha me të cilën do të bëhet pagesa është Lek nëpërmjet bankës **Raiffaisen Bank**, në llogarinë e Kontraktuesit me **IBAN:** [redacted]
Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

**Neni 8: Zgjidhja e kontratës**
Kontrata mund të zgjidhet duke pushuar çdo efekt të saj me njoftimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktor në rastet e mëposhtme :

1. Në rastin e morealizimit të sasisë së plotë të sherbimve sipas kërkesës së autoritetit kontraktor pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.
2. Në rast mosplotësimi të kërkesave të cilësisë sherbimve objekt kontrate dhe mospranimit nga Kontraktuesi për zëvëndësimin e kësaj sasie me një sasi tjetër të barabartë me të parën, që i përmbush këto kërkesa pas një njoftimi zyrtar me shkrim nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e mësipërm kontrata do të zgjidhet duke respektuar dispozitat e Kodit Civil.

**Neni 9: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**
Për çdo marreveshje që mund të lind në zbatimin e kontratës, nëse ato nuk zgjidhen në marrëveshje midis palëve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

## Kushtet e përgjithshme të kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**Neni 1 Dispozitat e përgjithshme**

**1.1 Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

**1.1.1 Kontrata**

1.1.1.1 "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

1.1.1.2 "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

1.1.1.3 "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.
1.1.1.4 "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
1.1.1.5 "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.
1.1.1.6 "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
1.1.1.7 "Termat e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
1.1.1.8 "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.
1.1.1.9 "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.
1.1.1.10"KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
1.1.1.11"KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**1.1.2 Palët e Kontratës**

1.1.2.1 "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.
1.1.2.2 "Blerës" do të thotë Autoriteti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.
1.1.2.3 "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimine Shërbimeve objekt kontrate.
1.1.2.4 "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

**1.1.3 Llogaritja e afateve**

1.1.3.1 "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

**1.1.4 Shërbimet**

1.1.4.1 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

**1.1.5 Përkufizime të tjera**

1.1.5.1 "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.
1.1.5.2 "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 "Forca Madhore".
1.1.5.3 "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 "Sigurimi i Kontratës".
1.1.5.4 "Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.
1.1.5.5 "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.
1.1.5.6 Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.
1.1.5.7 "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.
1.1.5.8 "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

**1.2 Interpretimi**

1.2.1 Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;
c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
d) (d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

**1.2.2 Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës

që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

1.2.3 **Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

1.2.4 **Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

1.3 **Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

b) Dhe

c) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

   (i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

   (ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

**1.4 Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

**1.5 Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

1.6 **Hartimi i Kontratës**

1.6.1 Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratësmidis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

1.6.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

**1.7 E drejta e autorit**

1.7.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

**1.8 Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Bleresi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

**1.9 Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) te ketij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

**1.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

1.11 **Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) ) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2 Praktikat e Ndaluara**

2.1 Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

2.2 Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3 Njoftimet**

a. Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

b. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4 Objekti i Furnizimit**

4.1 Shërbimet që do të furnizohen duhet të jenë sipas termave të referencës dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

4.2 Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5 Dorëzimi**

5.1 Dorëzimi i Shërbimeve do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 6 Përgjegjësitë e Furnizuesit**

6.1 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për kryerjen e e të gjitha Shërbimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Neni **7 Detyrimet e Përgjithshme të Furnizuesit**

7.1 Furnizuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuara në përgjithësi.

7.2 Furnizuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Blerësit, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Blerësit.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Furnizuesit**

8.1 Furnizuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës.

8.2 Furnizuesi duhet t'i paraqesë Blerësit të gjitha shërbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

8.3 Furnizuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Çmimi i Kontratës**

9.1 Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 19.

**Neni 10 Kushtet e Pagesës**

10.1 Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.
Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

10.2 Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

10.3 Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

10.4 Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 11 Sigurimi i Kontratës**

11.1 Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.

11.2 Në përputhje me Nenin 11.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.

11.3 Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.

11.4 Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 12 Nënkontraktimi**

12.1 Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.

12.2 Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për shërbimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit.

12.3 Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 13 Specifikime dhe Skicime**

13.1 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

13.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 14 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

14.1 Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

14.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shrbimeve që po sigurohen.

**Neni 15 Dëmet e likujduara**

15.1 Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 16 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

16.1 Furnizuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Bleresi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Furnizuesit.

16.2 Furnizuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Bleresi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Bleresi është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

16.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

16.4 Furnizuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Bleresit.

**Neni 17 Zhdëmtimi i Patentës**

17.1 Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Bleresin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Bleresi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

a) ofrimit të shërbimeve nga Furnizuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;

dhe

b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.

Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

17.2 Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Bleresit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 15.1, Bleresi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Bleresit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

17.3 Nëse Furnizuesi nuk e njofton Bleresin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Bleresi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

17.4 Bleresi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

17.5 Bleresi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Bleresit.

**Neni 18 Kufizimi i Përgjegjësisë**

18.1 Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Bleresit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Bleresit dëmet e likujduara; dhe

b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 19 Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

19.1 Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 20 Forca madhore**

20.1 Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

20.2 Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

20.3 Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

**Neni 21 Modifikimi i Kontratës**

21.1 Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

21.2 Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

21.3 Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 22 Zgjatja e afatit**

22.1 Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

22.2 Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 20, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

**Neni 23 Ndërprerja e Kontratës**

**23.1 Njoftim për të korrigjuar**

Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Bleresi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

**23.2 Ndërprerja për mospërmbushje**

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

(i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 23.1 të këtij neni;

(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 22; ose

(iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

**23.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

**23.4** Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 24 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

24.1 Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

24.2 Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë

**Kjo kontratë u përpilua në katër kopje duke u ndarë në tre kopje për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin.**
**Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konform vullnetit të dyja palët, të cilët e firmosën dhe e vulosen atë respektivisht në çdo faqe**

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**
**ADMINISTRATORI**
**Eljan HOXHA**

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"LLIXHA 2001" shpk**
**ADMINISTRATOR**
**Ardjan DAKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

## REKTORATI

## Aneks kontrate
## "Ekspedita mesimore dhe praktika në terren"

| Fakulteti | Nr | Intenerari | Data | Nr. Stud | Nr. Akad | Pers ona | Dist anca km | Çmimi me tvsh | Vlera me tvsh | Vlera pa tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **I** | | **Diplomë Jouniversitare Teknologji Laboratori** | | | | | | | | |
| FSHN | 1 | Elbasan - Fier | Prill 2024 | 49 | 6 | 55 | 75 | 365 | 20,075 | 16,729 |
| | 2 | Fier- Elbasan | Prill 2024 | 49 | 6 | 55 | 75 | 365 | 20,075 | 16,729 |
| | 3 | Elbasan - Korçë | Prill 2024 | 49 | 6 | 55 | 125 | 595 | 32,725 | 27,271 |
| | 4 | Korçë - Elbasan | Prill 2024 | 49 | 6 | 55 | 125 | 595 | 32,725 | 27,271 |
| | 5 | Elbasan -Vlorë | Maj 2024 | 49 | 6 | 55 | 130 | 595 | 32,725 | 27,271 |
| | 6 | Vlorë-Elbasan | Maj 2024 | 49 | 6 | 55 | 130 | 595 | 32,725 | 27,271 |
| | 7 | Elbasan - Librazhd | Nëntor 2024 | 49 | 6 | 55 | 25 | 120 | 6,600 | 5,500 |
| | 8 | Librazhd - Elbasan | Nëntor 2024 | 49 | 6 | 55 | 25 | 120 | 6,600 | 5,500 |
| | | **Shuma I** | | | | | | | **184,250** | **153,542** |
| **II** | | **(Ekologji-Florë- Vegjetacion), Bachelor në Studime Mjedisore, Kursi III** | | | | | | | | |
| FSHN | 1 | Elbasan -Divjakë | Maj 2024 | 9 | 4 | 13 | 63 | 305 | 3,965 | 3,304 |
| | 2 | Divjakë-Elbasan | Maj 2024 | 9 | 4 | 13 | 63 | 305 | 3,965 | 3,304 |
| | 3 | Elbasan-Gjinar | Maj 2024 | 9 | 4 | 13 | 23 | 120 | 1,560 | 1,300 |
| | 4 | Gjinar-Elbasan | Maj 2024 | 9 | 4 | 13 | 23 | 120 | 1,560 | 1,300 |
| | 5 | Elbasan-Pogradec | Maj 2024 | 9 | 4 | 13 | 84 | 415 | 5,395 | 4,496 |
| | 6 | Pogradec - Elbasan | Maj 2024 | 9 | 4 | 13 | 84 | 415 | 5,395 | 4,496 |
| | 7 | Elbasan - Tiranë | Maj 2024 | 9 | 4 | 13 | 40 | 190 | 2,470 | 2,058 |
| | 8 | Tiranë -Elbasan | Maj 2024 | 9 | 4 | 13 | 40 | 190 | 2,470 | 2,058 |
| | | **Shuma II** | | | | | | | **26,780** | **22,317** |
| **III** | | **Botanikë e përgjithshme, Bachelor në Biologji - Kimi, Kursi I** | | | | | | | | |
| FSHN | 1 | Elbasan -Divjakë | Maj 2024 | 14 | 4 | 18 | 63 | 305 | 5,490 | 4,575 |
| | 2 | Divjakë-Elbasan | Maj 2024 | 14 | 4 | 18 | 63 | 305 | 5,490 | 4,575 |
| | 3 | Elbasan-Gjinar | Maj 2024 | 14 | 4 | 18 | 23 | 120 | 2,160 | 1,800 |
| | 4 | Gjinar-Elbasan | Maj 2024 | 14 | 4 | 18 | 23 | 120 | 2,160 | 1,800 |
| | 5 | Elbasan-Pogradec | Maj 2024 | 14 | 4 | 18 | 84 | 415 | 7,470 | 6,225 |
| | 6 | Pogradec - Elbasan | Maj 2024 | 14 | 4 | 18 | 84 | 415 | 7,470 | 6,225 |
| | 7 | Elbasan - Tiranë | Maj 2024 | 14 | 4 | 18 | 40 | 190 | 3,420 | 2,850 |
| | 8 | Tiranë -Elbasan | Maj 2024 | 14 | 4 | 18 | 40 | 190 | 3,420 | 2,850 |
| | | **Shuma III** | | | | | | | **37,080** | **30,900** |
| **IV** | | **Bioekologji, Master i Shkencave "Mbrojtje Mjedisi" Kursi I** | | | | | | | | |
| FSHN | 1 | Elbasan-Divjakë | Maj- Qershor 2024 | 11 | 7 | 18 | 63 | 305 | 5,490 | 4,575 |
| | 2 | Divjakë-Elbasan | Maj- Qershor 2024 | 11 | 7 | 18 | 63 | 305 | 5,490 | 4,575 |
| | 3 | Elbasan-Gjinar | Maj- Qershor 2024 | 11 | 7 | 18 | 23 | 120 | 2,160 | 1,800 |
| | 4 | Gjinar-Elbasan | Maj- Qershor 2024 | 11 | 7 | 18 | 23 | 120 | 2,160 | 1,800 |
| | 5 | Elbasan-Pogradec | Maj- Qershor 2024 | 11 | 7 | 18 | 84 | 415 | 7,470 | 6,225 |
| | 6 | Pogradec - Elbasan | Maj- Qershor 2024 | 11 | 7 | 18 | 84 | 415 | 7,470 | 6,225 |
| | | **Shuma IV** | | | | | | | **30,240** | **25,200** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN



LLIXHA 2001 sh.p.k ELBASAN - ALBANIA

| Fakulteti | Nr | Intenerari | Data | Nr. Stud | Nr. Akad | Pers ona | Dist anca km | Çmimi me tvsh | Vlera me tvsh | Vlera pa tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **V** | | **Mikrobiologji Mjedisore, Master i Shkencave Mbrojtje Mjedisi, Kursi II** | | | | | | | | |
| | 1 | Elbasan -Korçë | Prill 2024 | 15 | 3 | 18 | 125 | 595 | 10,710 | 8,925 |
| | 2 | Korçë - Elbasan | Prill 2024 | 15 | 3 | 18 | 125 | 595 | 10,710 | 8,925 |
| | 3 | Elbasan - Durrës | Prill 2024 | 15 | 3 | 18 | 81 | 395 | 7,110 | 5,925 |
| | 4 | Durrës -Elbasan | Prill 2024 | 15 | 3 | 18 | 81 | 395 | 7,110 | 5,925 |
| | | **Shuma V** | | | | | | | **35,640** | **29,700** |
| **VI** | | **Zoologji I, Bachelor në Biologji Kimi Kursi I** | | | | | | | | |
| | 1 | Elbasan -Divjakë | Maj 2024 | 14 | 3 | 17 | 63 | 305 | 5,185 | 4,321 |
| | 2 | Divjakë-Elbasan | Maj 2024 | 14 | 3 | 17 | 63 | 305 | 5,185 | 4,321 |
| | 3 | Elbasan-Gjinar | Maj 2024 | 14 | 3 | 17 | 23 | 120 | 2,040 | 1,700 |
| **FSHN** | 4 | Gjinar-Elbasan | Maj 2024 | 14 | 3 | 17 | 23 | 120 | 2,040 | 1,700 |
| | 5 | Elbasan-Pogradec | Maj 2024 | 14 | 3 | 17 | 84 | 415 | 7,055 | 5,879 |
| | 6 | Pogradec - Elbasan | Maj 2024 | 14 | 3 | 17 | 84 | 415 | 7,055 | 5,879 |
| | 7 | Elbasan - Tiranë | Maj 2024 | 14 | 3 | 17 | 40 | 190 | 3,230 | 2,692 |
| | 8 | Tiranë -Elbasan | Maj 2024 | 14 | 3 | 17 | 40 | 190 | 3,230 | 2,692 |
| | | **Shuma VI** | | | | | | | **35,020** | **29,183** |
| **VII** | | **Zoologji II, Bachelor në Biologji Kimi Kursi II** | | | | | | | | |
| | 1 | Elbasan -Divjakë | Maj- Qershor 2024 | 11 | 3 | 14 | 63 | 305 | 4,270 | 3,558 |
| | 2 | Divjakë-Elbasan | Maj- Qershor 2024 | 11 | 3 | 14 | 63 | 305 | 4,270 | 3,558 |
| | 3 | Elbasan-Gjinar | Maj- Qershor 2024 | 11 | 3 | 14 | 23 | 120 | 1,680 | 1,400 |
| **FSHN** | 4 | Gjinar-Elbasan | Maj- Qershor 2024 | 11 | 3 | 14 | 23 | 120 | 1,680 | 1,400 |
| | 5 | Elbasan-Pogradec | Maj- Qershor 2024 | 11 | 3 | 14 | 84 | 415 | 5,810 | 4,842 |
| | 6 | Pogradec - Elbasan | Maj- Qershor 2024 | 11 | 3 | 14 | 84 | 415 | 5,810 | 4,842 |
| | 7 | Elbasan - Tiranë | Maj- Qershor 2024 | 11 | 3 | 14 | 40 | 190 | 2,660 | 2,217 |
| | 8 | Tiranë - Elbasan | Maj- Qershor 2024 | 11 | 3 | 14 | 40 | 190 | 2,660 | 2,217 |
| | | **Shuma VII** | | | | | | | **28,840** | **24,033** |
| **VIII** | | **Master i Shkencave në Gjuhësi Viti II** | | | | | | | | |
| | 1 | Elbasan - Durrës | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 81 | 395 | 5,135 | 4,279 |
| | 2 | Durrës - Fushë Krujë | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 34 | 170 | 2,210 | 1,842 |
| **FSHH** | 3 | Fushë Krujë - Shëngjin | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 42 | 220 | 2,860 | 2,383 |
| | 4 | Shëngjin- Elbasan | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 100 | 500 | 6,500 | 5,417 |
| | 5 | Elbasan - Shëngjin | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 100 | 500 | 6,500 | 5,417 |
| | 6 | Shëngjin- Shkodër (kalaja e Shkodrës) | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 44 | 220 | 2,860 | 2,383 |
| | 7 | Shkodër (kalaja e Shkodrës) - Elbasan | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 139 | 655 | 8,515 | 7,096 |
| | 8 | Elbasan - Shkodër | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 139 | 655 | 8,515 | 7,096 |
| | 9 | Shkodër- Vau i Dejës | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 21 | 90 | 1,170 | 975 |
| | 10 | Vau i Dejës - Velipojë | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 41 | 190 | 2,470 | 2,058 |
| | 11 | Velipojë - Elbasan | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 150 | 700 | 9,100 | 7,583 |
| | 12 | Elbasan - Kukës | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 184 | 870 | 11,310 | 9,425 |
| | 13 | Kukës - Prizren | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 46 | 220 | 2,860 | 2,383 |
| | 14 | Prizren - Elbasan | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 229 | 1,030 | 13,390 | 11,158 |

Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al

| Fakulteti | Nr | Intenerari | Data | Nr. Stud | Nr. Akad | Pers ona | Dist anca km | Çmimi me tvsh | Vlera me tvsh | Vlera pa tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| FSHH | 15 | Elbasan - Tamarë | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 196 | 910 | 11,830 | 9,858 |
| | 16 | Tamarë - Elbasan | Maj 2024 | 11 | 2 | 13 | 196 | 910 | 11,830 | 9,858 |
| | | **Shuma VIII** | | | | | | | **107,055** | **89,213** |
| **IX** | **Master i Shkencave Studime Historike, Ba në Histori Gjeografi Viti II, Diplomë profesionale Operator Turistik Viti I, Diplomë profesionale Operator Turistik në Gjuhë Gjermane** | | | | | | | | | |
| FSHH | 1 | Elbasan - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 2 | Tiranë - Peshkopi (Rruga e Arbrit) | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 99 | 500 | 23,000 | 19,167 |
| | 3 | Peshkopi (Rruga e Arbrit) - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 99 | 500 | 23,000 | 19,167 |
| | 4 | Tiranë - Elbasan | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 5 | Elbasan - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 6 | Tiranë - Shëngjin | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 70 | 335 | 15,410 | 12,842 |
| | 7 | Shëngjin - Shkodër | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 44 | 220 | 10,120 | 8,433 |
| | 8 | Shkodër - Ura e Mesit | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 9 | 50 | 2,300 | 1,917 |
| | 9 | Ura e Mesit - Razëm | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 45 | 220 | 10,120 | 8,433 |
| | 10 | Razëm - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 136 | 655 | 30,130 | 25,108 |
| | 11 | Tiranë - Elbasan | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 12 | Elbasan - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 13 | Tiranë - Fishtë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 75 | 365 | 16,790 | 13,992 |
| | 14 | Fishtë - Shkodër | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 34 | 170 | 7,820 | 6,517 |
| | 15 | Shkodër - Malësi e Madhe | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 32 | 170 | 7,820 | 6,517 |
| | 16 | Malësi e Madhe - Tamarë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 52 | 255 | 11,730 | 9,775 |
| | 17 | Tamarë - Vermosh | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 33 | 170 | 7,820 | 6,517 |
| | 18 | Vermosh - Shkodër | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 97 | 500 | 23,000 | 19,167 |
| | 19 | Shkodër - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 100 | 500 | 23,000 | 19,167 |
| | 20 | Tiranë - Elbasan | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 21 | Elbasan - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 22 | Tiranë - Vau i Dejës | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 98 | 500 | 23,000 | 19,167 |
| | 23 | Vau i Dejës - Shkodër | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 21 | 90 | 4,140 | 3,450 |
| | 24 | Shkodër - Shirokë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 6 | 50 | 2,300 | 1,917 |
| | 25 | Shirokë - Velipojë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 28 | 145 | 6,670 | 5,558 |
| | 26 | Velipojë - Kune Vain | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 58 | 280 | 12,880 | 10,733 |
| | 27 | Kune Vain - Shkodër | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 47 | 235 | 10,810 | 9,008 |
| | 28 | Shkodër - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 100 | 500 | 23,000 | 19,167 |
| | 29 | Tiranë - Elbasan | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 30 | Elbasan - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 31 | Tiranë - Kukës | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 147 | 700 | 32,200 | 26,833 |
| | 32 | Kukës - Prizren | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 46 | 235 | 10,810 | 9,008 |
| | 33 | Prizren - Kukës | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 46 | 235 | 10,810 | 9,008 |
| | 34 | Kukës - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 147 | 700 | 32,200 | 26,833 |
| | 35 | Tiranë - Elbasan | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 36 | Elbasan - Durrës | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 81 | 395 | 18,170 | 15,142 |
| | 37 | Durrës - Gjiri i Lalzit | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 35 | 170 | 7,820 | 6,517 |
| | 38 | Gjiri i Lalzit - Kepi i Rodonit | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 10 | 50 | 2,300 | 1,917 |
| | 39 | Kepi i Rodonit - Durrës | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 47 | 235 | 10,810 | 9,008 |
| | 40 | Durrës - Elbasan | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 81 | 395 | 18,170 | 15,142 |
| | 41 | Elbasan - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | 42 | Tiranë - Lezhë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 59 | 280 | 12,880 | 10,733 |
| | 43 | Lezhë - Krujë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 48 | 235 | 10,810 | 9,008 |

| Fakulteti | Nr | Intenerari | Data | Nr. Stud | Nr. Akad | Pers ona | Dist anca km | Çmimi me tvsh | Vlera me tvsh | Vlera pa tvsh |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| FSHH | 44 | Krujë - Tiranë | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 31 | 145 | 6,670 | 5,558 |
| | 45 | Tiranë - Elbasan | Maj 2024 | 37 | 9 | 46 | 40 | 190 | 8,740 | 7,283 |
| | | **Shuma IX** | | | | | | | **573,390** | **477,825** |
| **X** | | **Sporte jashtë auditorit (Turizëm)** | | | | | | | | |
| FSHE | 1 | Elbasan - Gjinar | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 25 | 120 | 12,480 | 10,400 |
| | 2 | Gjinar-Elbasan | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 25 | 120 | 12,480 | 10,400 |
| | 3 | Elbasan - Borovë | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 55 | 255 | 26,520 | 22,100 |
| | 4 | Borovë -Elbasan | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 55 | 255 | 26,520 | 22,100 |
| | 5 | Elbasan - Vlorë | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 130 | 595 | 61,880 | 51,567 |
| | 6 | Vlorë - Elbasan | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 130 | 595 | 61,880 | 51,567 |
| | 7 | Elbasan- Dardhë (Korçë) | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 140 | 655 | 68,120 | 56,767 |
| | 8 | Dardhë (Korçë) - Elbasan | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 140 | 655 | 68,120 | 56,767 |
| | 9 | Elbasan - Sotirë (Gramsh) | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 62 | 305 | 31,720 | 26,433 |
| | 10 | Sotirë (Gramsh) - Elbasan | Maj 2024 | 100 | 4 | 104 | 62 | 305 | 31,720 | 26,433 |
| | | **Shuma X** | | | | | | | **401,440** | **334,533** |
| **XI** | | **Sporte jashtë auditorit (Ski)** | | | | | | | | |
| FSHE | 1 | Elbasan - Voskopojë | Janar 2024 | 113 | 7 | 120 | 140 | 0 | 0 | 0 |
| | 2 | Voskopojë - Elbasan | Janar 2024 | 113 | 7 | 120 | 140 | 0 | 0 | 0 |
| | | **Shuma XI** | | | | | | | **0** | **0** |
| **Shuma për Shërbim Transporti** | | | | | | | | | **1,459,735** | **1,216,446** |

**PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**
**Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani"**
**ADMINISTRATORI**
**Eljan HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" - ELBASAN

**PËR KONTRAKTUESIN**
**"LLIXHA 2001" shpk**
**ADMINISTRATOR**
**Ardjan DAKA**

TRANSPORT UDHETARESH - ... TURISTIKE - LLIXHA 2001 sh.p.k - ELBASAN - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
ADMINISTRATORI

Nr. 1870/6 prot. Elbasan, me 16.09.2024

**KONTRATE PUBLIKE PËR SHËRBIME**
**"Mirëmbajtje e paisjeve në auditore e zyra- orendi"**

E lidhur sot në datë 16.09.2024 në Universitetin "A.Xhuvani" Elbasan, mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, bazuar në dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" , i ndryshuar, neni 122 Kreu XV, sipas kushteve të mëposhtme:

## KREU I: KUSHTET E VEÇANTA (Shërbime)

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

### Neni 1: Përkufizime

- Autoriteti Kontraktor është – **Universiteti i Elbasanit "A.Xhuvani", përfaqësuar nga Admistratori z. Eljan Hoxha,** njohur më poshtë si **"AUTORITETI KONTRAKTOR" (Blerësi Publik).**
- **Kontraktuesi** është Operatori Ekonomik **"BOLT" shpk**, i përcaktuar më poshtë si "KONTRAKTUESI" (sipërmarrësi), me seli në Tiranë, i regjistruar më dt. 17.03.2009, me NIPT me nr. K91517011V, me **administrator (drejtues ligjor) z. Bardhyl Beqiri**, i cili përfaqëson këtë subjekt për detyrimet e kësaj kontrate, më poshtë i referuar si KONTRAKTUESI (*personi juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet sherbime*).

### Neni 2 Objekti i Kontratës

Kontraktuesi do të kryejë shërbimin për mirëmbajtjen e pajisjeve në auditorë e zyra e orendi për nevoja të Autoritetit Kontraktor, kundrejt pagimit të vlerës së kontratës.
Ky shërbim do të jetë në sasi dhe cilësi, sikurse është përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe pranuar në dokumentacionin e ofertës të paraqitur nga Kontraktuesi në tenderin e zhvilluar më date 02.09.2024, sipas aneksit bashkëlidhur kontratës.

### Neni 3. Vlefta Kontratës

**Vlera totale e kontratës** (pa tvsh), sipas ofertës së paraqitur në tender nga subjekti fitues "BOLT" shpk, është **1,902,230** *(Njëmilion e nëntëqin e dymjië e dyqind e tridhjetë)* lekë. **Vlera e plotë e kontratës** (përfshirë tvsh) që do t'i paguhet kontraktuesit është **2,282,676** *(Dymilion e dyqind e tetëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë)* lekë.

Çmimi i parashikuar më sipër përfshin shërbimin për mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve në auditorë e zyra, për gjithë periudhën e vlefshmërisë së kontratës dhe përfshin të gjitha shpenzimet e kontraktuesit për shërbimin në fjalë, si dhe të gjitha detyrimet fiskale në fuqi. Autoriteti Kontraktor përgjigjet financiarisht ndaj Kontraktuesit vetëm për ndryshimin zyrtar të detyrimeve fiskale të Kontraktuesit gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

**Neni 4. Kushtet e Pagesës.**
Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm: Pagesa e çmimit të kësaj kontrate do të bëhet nga Autoriteti Kontraktor çdo muaj, në monedhën lekë nëpërmjet bankës Bankes Kombetare Tregetare, në llogarinë e Kontraktuesit [redacted] Pagesa do t'i bëhet Kontraktuesit brenda 30 ditëve nga data e arritjes së marrëveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor. Kur data e mësipërme është ditë pushimi zyrtar, pagesa do të bëhet ditën pasardhëse të punës. Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

**Neni 5. Fillimi i Kontratës**
Afati i levrimit të shërbimit objekt kontrate, nga Kontraktuesi do të jetë 35 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës

**Neni 6. Vendndodhja e Shërbimeve**
Kontraktuesi do të kryejë shërbimin e riparimit dhe mirëmbajtjes se mjeteve dhe pajisjeve të auditorëve e zyrave, në godinat e Universitetit të Elbasanit "A.Xhuvani" për riparimet e mundshme në objekt, ndërsa në ambjentet e operatorit ekonomik për riparimet e tjera, sipas tabelës së shpërndarjes bashkëlidhur.

**Neni 7. Sigurimi i kontratës**
Kontraktuesi për realizimin e detyrimit të tij në këtë kontratë brenda 10 ditësh nga marrja e njoftimit për nënshkrimin e kontratës detyrohet të paraqesë sigurimin e kontratës, në formën e Garancisë Bankare, ose Çertifikatës së Garancisë në Shoqëritë e Sigurimeve, për përmbushjen e detyrimeve të kontratës, në masën 10% të vlerës totale të kontratës, ose në vlerë absolute jo më pak se **228,268 lekë**.
Autoriteti Kontraktor do të bëjë çlirimin e garancisë së kontratës (10 %) brenda 30 ditëve duke filluar nga momenti i përmbushjes së të gjitha detyrimeve të Kontraktuesit.
Shuma e ngurtësuar do të konfiskohet nga Autoriteti Kontraktor, në rast të shkaktimit të dëmit si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga Kontraktuesi dhe kur ky i fundit nuk pranon të shlyejë dëmin, sipas përcaktimeve në këtë kontratë. Nuk parashikohet zbritje periodike e garancisë së kontratës.

**Neni 8: Detyrimet e Kontraktuesit.**
Kontraktuesi, me qëllim që të kryeje punën në kushtet e parashikuara në ketë kontratë ka të drejtë dhe është i detyruar të kryejë shërbimet sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës të përcaktuara respektivisht në shtojcën 8 dhe 11 të dokumentave të tenderit.

**Neni 9: Detyrimet e Autoritetit Kontraktor.**
Autoriteti Kontraktor detyrohet, në zbatim të kësaj kontrate:
1. T'i paguajë Kontraktuesit vlerën e kontratës, sipas përcaktimit të bërë në nenin .

2. Të sigurojë mundësinë e hyrjes në ambientet e universitetit (godinat e përcaktuara në nenin 6).

**Neni 10: Ndryshimet dhe prishja e kontratës**

1. Palët mund të bëjnë ndryshime në përmbajtjen e kontratës me pëlqim të të dy palëve me shkrim, kur një gjë e tille nuk ndalohet nga dispozitat ligjore në fuqi.
2. Kur Kontraktuesi tërhiqet nga kontrata ai do të shlyejë të gjitha detyrimet që kanë lindur nga realizimi i pjesëshëm i saj.
3. Në rast se Autoriteti Kontraktor tërhiqet nga kontrata Kontraktuesi mund të kërkojë dëmshpërblim vetem për atë pjesë të realizuar të kontratës.

**Neni 11: Dispozita të fundit**

Kontrata hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët.
Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt për zgjidhjen e tyre palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

## Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**Neni 1: Dispozitat e përgjithshme**

1.1 **Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1.1 **Kontrata**

1.1.1.1 "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

1.1.1.2 "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

1.1.1.3 "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

1.1.1.4 "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

1.1.1.5 "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.

1.1.1.6 "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Mallrave objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

1.1.1.7 "Termat e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

1.1.1.8 "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

1.1.1.9 "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

1.1.1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.1.1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.1.2 **Palët e Kontratës**

1.1.2.1 "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

1.1.2.2 "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Mallrave objekt kontrate.

1.1.2.3 "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që furnizon Mallrat objekt kontrate.

1.1.2.4 "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për ofrimin e një pjese të Mallrave ose Shërbimeve të Lidhura me to.

1.1.3 **Llogaritja e afateve**

1.1.3.1 "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

1.1.4 **Shërbimet**

1.1.4.1 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

1.1.5 **Përkufizime të tjera**

1.1.5.1 "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

1.1.5.2 "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 "Forca Madhore".

1.1.5.3 "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 "Sigurimi i Kontratës".

1.1.5.4 "Vendi i dorëzimit të Mallrave", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

1.1.5.5 "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

1.1.5.6 Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 23.

1.1.5.7 "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK

1.1.5.8 "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

1.2 **Interpretimi**

1.2.1 **Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:**

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;

(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;

(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;

(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

1.2.2 **Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

1.2.3 **Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

1.2.4 **Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

1.3 **Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa. Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

1.4 **Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë. Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

1.5 **Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Bleresi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

1.6 **Hartimi i Kontratës**

1.6.1 Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

1.6.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

1.7 **E drejta e autorit**

1.7.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha vizatimet, dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Bleresit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Bleresit, edhe nëse ato i janë furnizuar Bleresit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

1.8 **Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Mallrave të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Bleresi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

1.9 **Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës 1.9 (a) këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cenuar Nenin 7.1.

1.10 **Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

1.11 **Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për

(i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara,
ose

(ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2: Praktikat e Ndaluara**

1.1. Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

1.2. Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfiktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme. Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3: Njoftimet**

3.1 Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

3.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4: Objekti i Furnizimit**

4.1 Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të furnizohen duhet të jenë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

4.2 Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5: Dorëzimi**

5.1 Dorëzimi i Shërbimeve do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 6: Përgjegjësitë e Furnizuesit**

6.1 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për kryerjen e e të gjitha Shërbimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 7: Detyrimet e Përgjithshme të Furnizuesit**

7.1 Furnizuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuara në përgjithësi.

7.2 Furnizuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Blerësit, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Blerësit.

**Neni 8: Detyrimet e Veçanta të Furnizuesit**

8.1. Furnizuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës.

8.2. Furnizuesi duhet t'i paraqesë Blerësit të gjitha shërbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë. Furnizuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9: Çmimi i Kontratës**

9.1 Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 21.

**Neni 10: Kushtet e Pagesës**

10.1 Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.
Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë

10.2 Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

10.3 Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

10.4 Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 11: Sigurimi i Kontratës**

11.1 Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.

11.2 Në përputhje me Nenin 11.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.

11.3 Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.

11.4 Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 12: Nënkontraktimi**

12.1. Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.

Adresa: Rruga "Ismail Zyma" Elbasan, Tel & fax: +355 542 52593, Web: www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" - ELBASAN

12.2. Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit.

12.3. Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 13: Specifikimet dhe Skicime**

13.1. Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

13.2. Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 14: Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

14.1 Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

14.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

**Neni 15: Dëmet e likujduara**

15.1 Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 16: Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

16.1 Furnizuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Blerësi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Furnizuesit.

16.2 Furnizuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Blerësi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Blerësi është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

16.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

16.4 Furnizuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Blerësit.

**Neni 17: Zhdëmtimi i Patentës**

17.1 Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë

pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

(a) ofrimit të shërbimeve nga Furnizuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;
dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.

Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

17.2 Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 15.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

17.3 Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

**Neni 18: Kufizimi i Përgjegjësisë**

18.1 Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara;
dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 19: Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të

rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 20: Forca madhore**

20.1 Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

20.2 Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

20.3 Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

**Neni 21: Modifikimi i Kontratës**

21.1 Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

21.2 Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

21.3 Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 22: Zgjatja e afatit**

22.1 Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

22.2 Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 20, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

**Neni 23: Ndërprerja e Kontratës**

23.1 **Njoftim për të korrigjuar**
Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Bleresi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

23.2 **Ndërprerja për mospërmbushje**

(i) Bleresi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht: nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 23.1 të këtij neni;

(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Bleresi në përputhje me Nenin 22;
ose

(iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

23.3 **Ndërprerja për paaftësi paguese**
